

FONDI PËR TË DREJTËN HUMANITARE KOSOVË



DREJT:
NJË STRATEGJIE
KOMBËTARE TË
DREJTËSISË
TRANZICIONALE
PËR KOSOVËN



DREJT: NJË STRATEGJIE KOMBËTARE TË DREJTËSISË TRANZICIONALE PËR KOSOVËN

Thomas Osorio
Këshilltar i pavarur
31 Maj 2022

PËR AUTORIN

Thomas Osorio është një bashkëpunëtor i lartë kërkimor në KU Leuven, një ligjërues i pavarur dhe këshilltar. Para kësaj, z. Osorio ka pasur pozita ekzekutive; në Kroaci dhe B dhe H, duke përfshirë edhe atë të Këshilltarit për Sundimin e Ligjit për UNDP, Shef i Misionit për Tribunalin Ndërkombëtar për Krime të Luftës për Kroaci, Bashkërendues i Hetimeve - Komisioni i KB i Ekspertëve për Hetimin e Krimeve të Luftës, Zyrtar në terren i të Drejtave të Njeriut të KB gjatë konfliktit të viteve 92-95 në ish Jugosllavi dhe Këshilltar për Drejtësi për mbikëqyrjen e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë Tranzicionale në Bosnjë dhe Hercegovinë.

MIRËNJOHJE

Ky dokument nuk do të ishte i mundur pa hulumtimet e gjera dhe shkrimet e bëra nga ekspertët: Bekim Blakaj, Gëzim Visoka, Natasha Kandiç (Nataša Kandić), Besnik Beqaj, Besart Lumi, Thomas Unger, Kathelijne Schenkel, Kaltrina Shala, Nora Ahmetaj, Amer Alija si dhe pa nxitjen dhe përkushtimin e pandërprerë të organizatave të shoqërisë civile siç janë FDH Kosovë, Integra, PAX for Peace (PAX për Paqen), Impunity Watch (Vëzhgimi i mosndëshkueshmërisë), Centre for Peace and Tolerance (Qendra për Paqe dhe Tolerancë), le të përmendim vetëm disa prej tyre.



Funded by the
European Union

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Unioni Evropian përmes projektit “Transformimi i perceptimeve të konfliktit përmes rritjes së përfshirjes qytetare dhe të komuniteteve në Kosovë”.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe ai nuk pasqyron pikëpamjet e Unionit Evropian.

PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES

I. HYRJA	1
II. DREJTËSIA TRANZICIONALE	3
III. OBJEKTIVAT E DREJTËSISË TRANZICIONALE	4
IV. DREJT NJË STRATEGJIE TË DREJTËSISË TRANZICIONALE – PARIMET UDHËRRËFYESE	5
V. DREJTËSIA TRANZICIONALE - QASJA E BAZUAR NË TË DREJTAT	7
VI. MEKANIZMAT E DREJTËSISË TRANZICIONALE - E VËRTETA, DREJTËSIA, REPARACIONET	8
VII. ELEMENTËT MBËSHTETËS - ÇËSHTJE TË NDËRGËRSHETUARA	20
VIII. ANEKSET	22

HYRJE

Njëzet vite pas përfundimit të konfliktit të viteve 1998-1999, e kaluara komplekse dhe e diskutueshme e Kosovës vazhdon të ushtrojë ndikim në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik dhe në shanset për pajtimin dhe paqen afatgjate. Me vendosmëri të përtëritur për të trajtuar të kaluarën e trazuar të Kosovës, në muajin gusht të vitit 2021, Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në inaugurimin e një procesi me qëllim të zhvillimit të një Strategjie Kombëtare të Drejtësisë Tranzicionale, e cila do të “bashkonte të gjitha nismat dhe do të krijonte një platformë për veprime dhe bashkërendim midis nismave dhe një platformë referencë për të gjithë ata, të cilët merren me të kaluarën.”¹ Kryeministri publikisht i ka pranuar mangësitë në nismat e mëhershme dhe është zotuar për të ndrequr gabimet e së kaluarës si dhe për adoptimin e një qasjeje më përfshirëse, duke e theksuar “nevojën kritike” për organizatat e shoqërisë civile, institucionet e shtetit, hulumtuesit, dhe qytetarët për të bashkuar forcat me qëllim të mbështetjes së këtij procesi të ripërtëritur. Kryeministri më tutje e ka theksuar se [Kosova] “nuk e ka luksin” e përsëritjes së gabimeve të mëhershme dhe se ka qenë jetike për shtetin dhe aktorët jo-shtetëror “për të bashkuar forcat” në mbështetjen e këtij procesi.

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës ka themeluar grupin punues për hartimin e strategjisë dhe ka theksuar rëndësinë e përfshirjes së zërit të viktimave në hartimin e saj. Ajo ka thënë se ajo do të angazhohet “për hartimin e një strategjie të gjithëmbarshme të përqendruar në viktimat dhe një strategjie të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore” dhe se ajo do të sigurojë që zhvillimi i saj do të bëhet në këshillim me palët e interesuara me qëllim të reflektimit për përvojat, nevojat dhe të drejtat e viktimave.²

“Ky është momenti i fundit për përballjen e duhur me të shkuarën. Është momenti i fundit për të trajtuar gjithçka që ka ndodhur. Të maten dëmet, të riparohen, të përmbushet e drejta për të vërtetën për viktimat e krimit, të mbijetuarit dhe familjet e tyre.”

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI

Shoqëria civile dhe aktivistët e të drejtave të njeriut në Kosovë po ashtu e kanë mirëpritur nismën e ripërtëritur nga autoritetet e Kosovës, duke rekomanduar se një nivel më i lartë i transparencës dhe komunikimi aktiv me të gjithë aktorët kërkohet për të informuar lidhur me procesin më mirë si dhe për ta fituar besimin dhe mbështetjen e përfituesve dhe të elitës politike në grupet e veçanta të viktimave si dhe në shumicën e heshtur në një shoqëri e cila e mbështet pajtimin. Në këtë kontekst, shoqëria civile kuptohet si OJQ, OSHC, aktivist individual, persona dhe grupe të njohura, asociacione të grave dhe të rinjve, grupe të viktimave, grupe të veteranëve, si dhe Diaspora e Kosovës dhe e Serbisë. Mësimet e mësuara nga programet e krahasueshme demonstrojnë se këta aktor të veçantë luajnë një rol themelor dhe katalitik në përparimin e Drejtësisë Tranzicionale, të të drejtave të njeriut, si dhe në sundimin e ligjit. Pos kësaj, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë dhe në rajon e kanë demonstruar kapacitetin dhe aftësinë për të ndikuar në ndryshimin dhe në promovimin e një kornize të një politike përfshirëse të duhur për agjendën e pajtimit dhe të një paqeje të qëndrueshme.

¹Prime Minister Kurti: Strategy on TJ should unite all initiatives (2021) (Kryeministri Kurti: Strategjia mbi DT duhet të bashkojë të gjitha nismat), <https://kryeministri.rks-gov.net/en/prime-minister-kurti-at-the-working-group-meeting-the-strategy-on-transitional-justice-should-unite-all-initiatives-to-address-the-past/>

²Office of the Prime Minister, 18.08.2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/kryeministri-kurti-ne-takimin-e-grupit-punues-strategjia-per-drejtisine-tranzicionaleduhet-te-bashkoje-te-gjitha-nismat-per-adresim-te-se-kaluares/>

se këta aktor të veçantë luajnë një rol themelor dhe katalitik në përparimin e Drejtësisë Tranzicionale, të të drejtave të njeriut, si dhe në sundimin e ligjit. Pos kësaj, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë dhe në rajon e kanë demonstruar kapacitetin dhe aftësinë për të ndikuar në ndryshimin dhe në promovimin e një kornize të një politike përfshirëse të duhur për agjendën e pajtimit dhe të një paqeje të qëndrueshme.

Në fazën e hartimit të SKDT, shoqëria civile po ashtu është një partner thelbësor për të ndihmuar lehtësimin si dhe për të zhvilluar aktivitete informuese në terren dhe për të siguruar udhëzime orientuese për viktimat dhe për grupet e marginalizuara me qëllim që të sigurohemi se nevojat dhe pikëpamjet e tyre janë të adresuara në Strategji. Në fund, aktorët e shoqërisë civile sigurojnë se projekti është i qëndrueshëm dhe se viktimat mbesin prioriteti i tyre në fazën e implementimit. Në veçanti, sigurojnë se dimensionin gjinor është i përfshirë gjatë gjithë procesit. Pos kësaj, nëse trupat implementuese dështojnë në përmbushjen e përgjegjësisë së tyre, shoqëria civile mund të ndër marrë veprime korrektuese për të mbështetur vazhdimësinë e papenguar të procesit. Në këtë drejtim, shoqëria civile në Kosovë dhe në rajon i mirëpret përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për të zhvilluar SKDT.

Për të mbështetur zhvillimin e Strategjisë, Ministrja e Drejtësisë ka caktuar një grup pune me 26 anëtarë për të kryer kërkime dhe konsultime me palët e interesuara dhe përfundimisht për të hartuar një dokument për procedurën parlamentare dhe për zbatimin. Ky angazhim i ripërtërirë shënon një nivel të ri të pjekurisë politike dhe mundësive për shoqërinë në Kosovë, duke operacionalizuar në mënyrë efektive objektivat politike afatgjata të Kosovës "për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë, për promovimin e drejtësisë dhe të pajtimit - një parakusht për të promovuar stabilitetin politik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik."

Drejtësia Tranzicionale për një kohë të gjatë ka qenë pjesë e arkitekturës së paqe-ndërtimit të Kosovës me instrumente të zbatuara ose të përlehtësuara nga trupat ndërkombëtarisht të mandatuara siç janë UNMIK-u, EULEX-i, ICTY, dhe të tjera, kryesisht për të adresuar sundimin e ligjit dhe ndjekjen e mizorive të luftës.³ "Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës", që i ka përfunduar negociatat me Serbinë për pavarësinë e Kosovës, i ka obliguar autoritetet e Kosovës për të ndër marrë nisma të drejtësisë tranzicionale si dhe masa për të ndërtuar paqen dhe për të përforcuar pajtimin.

Përpjekja e parë e Kosovës për të hartuar një Strategji ka qenë ndihmuar nga Grupi punues ndërministror që e ka trajtuar të kaluarën dhe pajtimin - në vitin 2008. Megjithatë, sipas një vëzhgimi të shoqërisë civile⁴, puna ka qenë e penguar rëndë nga mangësitë në lidhje dhe në menaxhim, nga pronësia politike, përfaqësimi dhe pjesëmarrja e komuniteteve pakicë të Kosovës si dhe angazhimi publik. Megjithatë, studimi ka arritur të përfundimi se angazhimi i sinqertë i Grupit Punues ka qenë përtej çdo dyshimi dhe se anëtarët e tij kanë merituar mirënjohjen nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Sidoqoftë, dështimi i nismës ka qenë rezultat i disa të metave specifike të projektit si dhe e mungesës së madhe të vullnetit politik dhe bashkërenditjes.

Drejtësia Tranzicionale luan një rol thelbësor në diskursin publik dhe politik nga perspektiva e vështrimit shoqëror. Iniciativat dhe projektet në shkallë të vogël, të financuara ndërkombëtarisht, të fokusuara në multikulturalizëm, në tolerancë dhe në diversitet në Kosovë kanë qenë posaçërisht të suksesshme në kapërcimin e boshllëqeve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë e trajtimit të së kaluarës. Pos kësaj, nismat rinore janë veçanërisht efikase në promovimin e të drejtave të njeriut, vlerave demokratike dhe drejtësisë tranzicionale në nivele lokale dhe rajonale, duke e

³Këtu përfshihen tribunalet ndërkombëtare (ICTY dhe MICT), dhe tribunalet hibride (the Kosovo Specialist Chambers) dhe mekanizmat e kërkimit të së vërtetës (Truth and Reconciliation Commission and RECOM)

⁴<http://kosovomemory.org/wp-content/uploads/2018/10/Civil-society-review-of-progress-toward-a-National-Strategy-on-Transitional-Justice.pdf>

adoptuar një perspektivë të orientuar nga e ardhmja drejt zhvillimit shoqëror dhe institucional.

Një studim i fundit ka gjetur se shumica e qytetarëve në Kosovë do të mbështesnin një platformë qeveritare/shoqërie civile për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me konfliktin e Kosovës dhe për të krijuar kushte për pajtim.⁵ Studimi sugjeron se çdo përpjekje e ardhshme duhet të përfshijë angazhimin politik efikas dhe të paanshëm si dhe të njohë nevojat e artikuluar nga viktimat dhe komunitetet e prekura. Për më tepër, raporti ka zbuluar se shumë përpjekje për të adresuar të kaluarën e trazuar të Kosovës janë instrumentalizuar me qëllim të përfitimit të një pikëpamjeje të caktuar politike, si dhe agjenda dhe grupe etnike që mbështesin një përkatësi të caktuar politike.

II. DREJTËSIA TRANZICIONALE

Drejtësia tranzicionale është një fushë multidisiplinare e teorisë dhe e praktikës për të kundërshtuar mosndëshkueshmërinë dhe për të rivendos dinjitetin e viktimave të shkeljeve të drejtave të njeriut përmes një modeli reciprokisht ripërforsues të "mekanizmave institucional" të krijuara dhe të implementuara për të adresuar të kaluarën në një mënyrë konstruktive dhe të orientuar nga e ardhmja. Për më tepër, drejtësia tranzicionale kërkon të krijojë kohezion social të qëndrueshëm dhe të rivendosë besimin qytetar, sundimin e ligjit, rendin demokratik dhe, përfundimisht, të arrijë pajtimin. Elementet kritike të nevojshme për të siguruar këto janë: njohja e viktimave, rritja e besimit të individëve ndaj shtetit, përforsimi i respektit për të drejtat e njeriut, promovimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e mundësive për pajtim dhe paqe të qëndrueshme.

Në vitin 2004, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e ka artikuluar drejtësinë tranzicionale si "spektër i plotë i proceseve dhe i mekanizmave që lidhen me përpjekjet e një shoqërie për t'u pajtuar me një trashëgimi të abuzimeve në shkallë të gjerë në të kaluarën për të garantuar llogaridhënie, për të siguruar drejtësinë dhe arritjen e pajtimit".⁶ Në këtë drejtim, drejtësia tranzicionale i përfshin katër mekanizma: drejtësinë, kërkimin e së vërtetës, dëmspërblimet, reformën institucionale dhe garancitë e mospërsëritjes, që duhet të përforsohen reciprokisht dhe të zbatohen në mënyrë holistike. Konceptet dhe instrumentet e aplikuara synojnë të zbatohen si një formë e partneritetit publik - shoqëri civile, i cili i ndërlidh mekanizmat gjyqësorë dhe ata jo-gjyqësorë, me kushtin që shoqëria të jetë e gatshme dhe e përgatitur për t'u përbashkët me të kaluarën e saj të përbashkët dhe e gatshme dhe e vullnetshme për të kërkuar një të ardhme të përbashkët.

Në këtë drejtim, suksesi i drejtësisë tranzicionale matet me aftësinë e procesit për të ofruar dëmspërblim jo vetëm për individët, por edhe një transformim më të gjerë shoqëror, i cili e përfshin vendosjen e kohezionit të qëndrueshëm shoqëror, bashkëjetesën paqësore dhe pajtimin. Së këndejmi, masat e drejtësisë tranzicionale duhet të inkurajojnë transformimin politik, shoqëror dhe ekonomik dhe të avancojnë barazinë gjinore, me dy objektiva të dallueshme: a) arritjen e drejtësisë për viktimat dhe b) dhe krijimin e shoqërive të drejta, gjithëpërfshirëse dhe paqësore.⁷

Drejtësia tranzicionale - Spektër i plotë i proceseve dhe i mekanizmave që lidhen me përpjekjet e një shoqërie për t'u pajtuar me një trashëgimi të abuzimeve në shkallë të gjerë në të kaluarën për të garantuar llogaridhënie, për të siguruar drejtësinë dhe arritjen e pajtimit.

KOMBET E BASHKUARA 2004

⁵New Social Initiative, Integra, and PAX December 2020 Authors: Dr Gëzim Visoka & Besart Lumi, <https://paxforpeace.nl/media/download/Citizens%20Perspective%20on%20a%20Future%20Strategy%20for%20Transitional%20Justice%20in%20Kosovo%20PAX%202020.pdf>

⁶Report of the Secretary-General, The Rule of Law and Transitional Justice in Conflict and Post-Conflict Societies UN Security Council, August 23, 2004.

⁷Paige A. (2009). How "Transitions" Reshaped Human Rights: Human Rights Quarterly, Volume 31/2. The Johns Hopkins University Press DOI: 10.1353/hrq.0.0069

Vështruar prej një këndvështrimi konceptual dhe praktik, masat e drejtësisë tranzicionale nuk duhet të funksionojnë të izoluar ose paralelisht me aktivitete të tjera transformuese ose zhvillimore. Për shembull, pa kërkimin e së vërtetës, reformat institucionale ose dëmshpërblimet për viktimat, ndëshkimi i një numri të kufizuar të kryerësve të krimeve të luftës, mund të interpretohen thjesht si një formë revanshi ose hakmarrjeje politike. Kërkimi i së vërtetës, i izoluar nga llogaridhënia dhe dëmshpërblimi për viktimat, sërish dështon t'iu sigurojë viktimave drejtësi apo pranim shoqëror. Dëmshpërblimet, pa lidhje të drejtpërdrejta me masat e tjera të drejtësisë tranzicionale, mund të perceptohen si një përpjekje për të blerë heshtjen ose pranimin e viktimave. Prandaj, SKDT duhet të kërkojë një nivel të lartë komplementariteti për të mbështetur viktimat dhe shoqërinë dhe pritshmëritë e tyre legjitime për drejtësi, për të vërtetën dhe për dëmshpërblimin.

Proceset e drejtësisë tranzicionale, në thelb, janë procese politike, pasi që ato shpesh përfshijnë vendime dhe veprime kontestuese të bazuara në pushtet, në interes dhe në maturi.⁸ Rrjedhimisht, proceset e drejtësisë tranzicionale nuk janë asnjëse apo thjesht teknike, por duhet të pranohen si politike, që mund të prodhojnë efekte pozitive dhe negative.⁹ Së pari, pra, zbatimi i masave të drejtësisë tranzicionale kërkon strukturim dhe renditje efektive për të maksimizuar komplementaritetin dhe për të minimizuar kontradiktat dhe nismat paralele. Së dyti, marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet masave duhet të jenë të qarta dhe të zbatueshme për të nxitur pjesëmarrjen dhe mbështetjen më të gjerë të publikut. Jo vetëm kaq, masat e drejtësisë tranzicionale duhet të renditen në atë mënyrë që të ruajnë dhe të përmirësojnë elementët përbërës të procesit të tranzicionit dhe qëllimet përfundimtare të pajtimit, të demokracisë dhe paqes së qëndrueshme.

III. OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË DREJTËSISË TRANZICIONALE

Qëllimi kryesor i një strategjie të drejtësisë tranzicionale është t'iu sigurojë viktimave dhe të mbijetuarve dëmshpërblim për shkeljet e pësuarat të drejtave të njeriut, vendosjen e besimit në legjitimitetin e shtetit dhe funksionin e sundimit të ligjit, vendosjen e kohezionit social të qëndrueshëm dhe kërkimin e pajtimit. Duke ofruar qasje në drejtësi, tensionet sociale, etnike dhe kulturore zgjidhen në mënyrë paqësore dhe rrugët për individët për të ndjekur në mënyrë aktive drejtësinë materiale dhe dëmshpërblimet mund të arrihen përmes proceseve gjyqësore dhe jo-gjyqësore. Në këtë drejtim, drejtësia tranzicionale është gjithashtu një mjet për parandalimin e konflikteve duke i vërtetuar faktet, duke e luftuar dezinformimin, narrativët përçarës, revizionizmin historik dhe gjuhën e urrejtjes. Ky aspekt parandalues dhe spastrues është gjithashtu jetik në hapjen e mundësive për refugjatët që ata të kthehen në shtëpitë e tyre në një mjedis më të rehatshëm dhe më të sigurt.

Qëllimet e drejtësisë tranzicionale janë të artikuluara në instrumentet dhe në programet kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat mbështesin gjerësisht: sundimin e ligjit, paqen, zhvillimin dhe pajtimin.

Për shembull, shënimi udhëzues i vitit 2010 i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së thotë se Drejtësia Tranzicionale "mund të kontribuojë në arritjen e objektivave më të gjera të parandalimit të konflikteve të mëtejshme, të ndërtimit të paqes dhe të pajtimit".¹⁰

¹⁰UN General Assembly - https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/A_HRC_49_39_E.pdf

Drejtësia Tranzicionale, si një proces transformues, përfshin mekanizma gjyqësorë dhe jo-gjyqësorë, të cilat mbështeten reciprokisht, duke përfshirë këtu edhe kërkimin e së vërtetës, nismat e ndjekjes penale, dëmshpërblimet dhe masat për të parandaluar përsëritjen e dhunës, si dhe duke përfshirë reformën ligjore dhe institucionale, forcimin e shoqërisë civile, përpjekjet për përkujtim, iniciativat kulturore, ruajtjen e arkivave dhe reformën e arsimit të historisë.¹¹

IV. DREJT NJË STRATEGJIE TË DREJTËSISË TRANZICIONALE

Qëllimi i këtij udhëzuesi: Drejt Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë Tranzicionale për Kosovën është të ofrojë një referencë dhe qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e një strategjie në përputhje me normat, me standardet dhe me praktikën më të mira ndërkombëtare. Udhëzuesi është specifik për Kosovën, i bazuar në informatat nga hulumtimet bashkëkohore, praktikën më të mira nga nismat e kaluara të drejtësisë tranzicionale dhe nga konsultimet me aktivistët dhe palët e interesuara. Udhëzuesi synon të lëviz përtej narrativave mbizotëruese dhe të përcjellë një qasje gjithëpërfshirëse, një qasje të përqendruar te viktimat, qasje kjo e aftë për të adresuar nevojat e vërteta dhe të orientuara drejt së ardhmes së individëve dhe komuniteteve në Kosovë.

PARIMET UDHËZUESE

"Strategjia" është një plan i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, me qëllim të arritjes së një ose më shumë objektivave afatgjata ose të gjithëmbarshme nën kushtet e mbizotërimit të pasigurisë. Një strategji mbështetëse është jashtëzakonisht e rëndësishme për drejtësinë tranzicionale, pasi ajo përfshin; vendosjen e qëllimeve dhe të prioritetëve, hartimin e veprimeve për arritjen e atyre synimeve si dhe mobilizimin e burimeve për të ekzekutuar aktivitetet ose veprimet e nevojshme. Përveç kësaj, Strategjia përshkruan dhe rendit se si proceset dhe mekanizmat individual do të arrijnë qëllimet e tyre të përcaktuara.

Koha dhe renditja e fillimit dhe e zbatimit të aktiviteteve të drejtësisë tranzicionale duhet të planifikohen me kujdes me qëllim që të maksimizojë ndikimin dhe të minimizojë rreziqet. Analiza politike dhe e konflikteve mund të ndihmojë në identifikimin e rreziqeve, të ndryshimeve në strukturat nxitëse dhe mundësive të reja për të promovuar drejtësinë tranzicionale.

Hartimi i SKDT duhet të përfshijë një proces të këshillimit gjithëpërfshirës me një grup të gjerë të palëve të interesuara - duke përfshirë këtu organizatat e shoqërisë civile, grupet e viktimave, gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara, thelbësore për të siguruar integritetin dhe pranimin publik të procesit. Pajtueshmëria dhe integrimi i plotë i parimeve, i normave dhe i standardeve ndërkombëtare janë të një rëndësie thelbësore në hartimin dhe në zbatimin e një Strategjie Kombëtare të Drejtësisë Tranzicionale. Së këndejmi, janë propozuar dhjetë parimet e mëposhtme për të ndihmuar në drejtimin e hartimit të STDT me qëllim që të arrihet ndikimi dhe qëndrueshmëria maksimale:

Ky udhëzues mbështet komunitetet e prekura nga konflikti në Kosovë për të kërkuar drejtësi dhe pajtim si një parakusht kritik për paqen dhe prosperitetin e qëndrueshëm.

TPNJ

1 Fushëveprimi dhe natyra - SKDT duhet të përfshijë të gjitha ngjarjet nga muaji janar i vitit 1998 deri në muajin dhjetor të vitit 2000, duke e pranuar plotësisht se drejtësia tranzicionale dhe pajtimi do të arrihen vetëm me përfshirjen e të gjitha grupeve të interesuara.

2 Qasja e përqendruar te viktimat - qasja gjithëpërfshirëse duhet të jetë e përqendruar te viktimat,

3 Ndërgjegjësimi situacional (parimi - të mos bëhet dëm) - pasi drejtësia tranzicionale merret me çështje të ngarkuara në aspektin emocional e të cilat lidhen me ngjarjet e kaluara traumatike, ekziston një rrezik i brendshëm i ripërtëritjes së tensioneve dhe, madje, edhe i dhunës. Së këndejmi, një qasje e ndjeshme ndaj konfliktit është gjithashtu jetike në planifikimin dhe në zbatimin e aktiviteteve. Kjo e kërkon një analizë të kujdesshme të pikave të dobëta shoqërore dhe politike, ndikimin e mundshëm të masave të drejtësisë tranzicionale si dhe integrimin e strategjive dhe të politikave për zbutjen e rrezikut për të kontrolluar efektet negative të procesit ose të manipulimit politik.

4 Qasja gjithëpërfshirëse (ose holistike)- Masat e drejtësisë tranzicionale nuk duhet të jenë të izoluar ose në konkurrencë me procese të tjera transformuese ose zhvillimore, por, para së gjithash, duhet të jenë reciprokisht përforcuese dhe mbështetëse për çështjet dhe reformat ndër-sektoriale. Një qasje gjithëpërfshirëse kërkon një strategji koherente dhe të kufizuar në kohë, në të cilën secili element vepron së bashku me, të tjerët dhe ofron hapësirë për nisma të tjera.

5 Menaxhimi i të pritshmërive - proceset nuk duhet të rrisin në mënyrë të rreme pritshmëri ose të bëjnë zotime joreale ndaj individëve ose komuniteteve. Është jetike të merren parasysh pritshmëritë dhe pikëpamjet e viktimave lidhur me procesin e Drejtësisë Tranzicionale, pasi që perceptimet e viktimave mund të ndryshojnë gjithashtu nga proces X aktual. SKDT duhet të sigurojë shkallën më të lartë të transparencës dhe të komunikimit gjatë të gjitha fazave të planifikimit dhe të vendimmarrjes. Drejtësia Tranzicionale është një proces, jo një destinacion: prandaj, transparenca dhe komunikimi i hapur do të ndihmojnë në menaxhimin e pritshmërive dhe do të nxisin pronësinë dhe përfshirjen.

6 Barazi gjinore - të orientojë barazinë gjinore dhe çështjet gjinore të lidhura me konfliktin si një pjesë ndërsektoriale dhe integrale e SKDT. Pabarazia gjinore është shpesh e lidhur ngushtë me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe me pasojat e këtyre shkeljeve. Përvojat e viktimave të konfliktit përfshijnë dhunën seksuale, por edhe një varg të shkeljeve gjinore të të drejtave të njeriut dhe shkelje socio-ekonomike.

7 Vendorsja e kornizave realiste të kohës - hartuesi duhet të marrë parasysh kontekstin e veçantë dhe të propozojë masa individuale të drejtësisë tranzicionale si dhe të marrë parasysh zhvillimin e një mjedisi të favorshëm (kushtet e sigurisë, ato politike, sociale dhe ekonomike, kapacitetet e strukturave ekzistuese dhe pozicionin e shoqërisë civile) me qëllim të përmbushjes së masave. Ky aktivitet mund të kërkojë renditje dhe një qasje të ndarë në faza për të lidhur mekanizmat dhe proceset e ndryshme.

8 Integriteti dhe paaënësia - të gjithë anëtarët duhet të kontrollohen me qëllim të konfirmimit të integritetit personal dhe politik, duke e përfshirë këtu edhe ekspertizën profesionale në lidhje me përshtatshmërinë për të shërbyer në grupin e punës. Pos kësaj, Grupi i Punës duhet t'iu përmbahet kushteve specifike, të cilat e sigurojnë pavarësinë e tij, duke e përfshirë kontrollin e burimeve, kryerjen e hetimeve, ndërtimin e marrëdhënieve dhe dhënien e rekomandimeve thelbësore.

Këta elementë janë të një rëndësie kritike, pasi tregojnë se procesi është i lirë nga manipulimi politik, i aftë për diskutime të paanshme dhe i hapur për shqyrtim publik.

9 Angazhimi i shoqërisë civile: Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) janë një partner thelbësor në mbështetjen e drejtësisë tranzicionale, partner i cili i lidh viktimat me informacionin dhe burimet.

10 Kontributi drejt pajtimit - drejtësia tranzicionale është një proces, jo një destinacion. Derisa pajtimi synon të transformojë marrëdhëniet midis individëve dhe t'i mundësojë shoqërisë të lëvizë nga një e kaluar e ndarë në një të ardhme të përbashkët, nismat e drejtësisë tranzicionale duhet të synojnë dimensionet institucionale dhe personale, siç janë faljet zyrtare, ngjarjet përkujtimore dhe memorialët në të gjitha nivelet e shoqërisë. Pos kësaj, mjetet për të luftuar "pengesat ndaj pajtimit" si gjuha e urrejtjes, glorifikimi i kriminelëve të luftës dhe narrativat përçarëse, etnocentrike, duhet të integrohen në Strategjinë me qëllim të mbrojtjes nga revizionizmi historik dhe konflikti ndëretnik.

11 Mbështetja e sundimit të ligjit - sundimi i ligjit nënkupton që ligjet e Kosovës, zbatimi i ligjit dhe marrëdhëniet ndërmjet rregullave ligjore janë vetë të rregulluara ligjërisht në mënyrë që askush – duke përfshirë këtu edhe zyrtarin më të lartë – të mos jetë mbi ligjin. Në kontekstin e Drejtësisë Tranzicionale – ndjekja e drejtësisë për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut duhet të mbështetet plotësisht dhe të depolitizohet në një mënyrë që respekton prezumimin e pafajësisë për të pandehurit dhe të drejtat e tyre për një gjykim të drejtë, duke ruajtur të drejtat dhe dinjitetin e viktimave dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procesin gjyqësor.

V. DREJTËSIA TRANZICIONALE - QASJE E BAZUAR NË TË DREJTAT

Që drejtësia tranzicionale të jetë efektive, ajo duhet të "bazohet në të drejtat" - e tillë që fokusohet në të drejtat dhe në nevojat e viktimave dhe të shoqërisë, si tërësi. Udhëzimet dhe rekomandimet e zbatohen këtu (qasje) si një kornizë konceptuale imponuese të vendosur në ligjet dhe në praktikën e qeverisjes së mirë. Me këtë qasje, SKDT është ancoruar në një sistem "të drejtash" dhe detyrimesh ligjore dhe politike përkatëse të përcaktuara nga e drejta ndërkombëtare, duke i përfshirë të drejtat civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale si dhe të drejtën për zhvillim. Prandaj, SKDT duhet të kërkojë të përfshijë një kornizë konceptuale të bazuar në parimet themelore të të drejtave të njeriut (universaliteti, pandashmëria, barazia dhe mosdiskriminimi, pjesëmarrja, llogaridhënia), e aftë për t'i udhëhequr 'mbajtësit e të drejtave' për të kërkuar të drejtat e tyre dhe "bartësit e detyrave" për të përmbushur detyrimet e tyre.

Parimet Joinet/Orentlicher, "parimet kundër mosndëshkimit",¹² e ofrojnë një udhëzim konceptual "të bazuar në të drejtat" për hartimin e Strategjisë, e cila përfshin: të drejtën për të ditur, të drejtën për drejtësi, të drejtën për dëmshpërblim si dhe të drejtën për garanci të mospërsëritjes.

- **E drejta për të ditur** - E drejta për të ditur përfshin të drejtat e viktimave dhe të familjeve të tyre për të mësuar të vërtetën lidhur me atë që iu ka ndodhur atyre ose njerëzve të tyre të dashur. Pos kësaj, kjo e drejtë bazohet në të drejtën e patjetërsueshme të shoqërisë për të mësuar rrethanat, të cilat kanë çuar në shkeljet e me qëllim të parandalimit të përsëritjes së tyre në të

¹² In Annex

ardhmen. Për më tepër, ajo përfshin detyrimin e shtetit për të ndërmarrë masa, të tilla siç është sigurimi i arkivave dhe i provave të tjera, ruajtja e kujtesës kolektive nga zhdukja dhe mbrojtja kundër revizionizmit dhe mohimit historik.

- **E drejta në drejtësi** - nënkupton që viktimat kanë të drejtë dhe se iu ofrohet një mjet juridik i drejtë dhe efektiv, duke përfshirë pritshmërinë që personi ose personat përgjegjës do të mbahen përgjegjës me mjete gjyqësore dhe se do të ketë dëmshpërblime. E drejta në drejtësi, gjithashtu, i detyron shtetet të hetojnë shkeljet dhe të ndjekin penalisht personat përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe të ndërmarrin veprime ndëshkuese nëse vërtetohet fajësia. Gjykatat kombëtare e kanë përgjegjësinë kryesore për të ushtruar juridiksionin; megjithatë, gjykatat penale ndërkombëtare ose hibride mund të ushtrorjnë juridiksion të njëkohshëm, siç ndodh me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
- **E drejta në dëmshpërblim** - përfshin masat e zbatuara nga shteti që viktimat, familjet dhe komunitetet e tyre të rikthehen në një gjendje që ekzistonte përpara konfliktit ose shkeljeve. Të drejtat mund të plotësohen në formën e kompensimit, për dëmtimin fizik ose mendor, për mundësitë e humbura në lidhje me punësimin ose arsimimin, ose në formën e rehabilitimit, d.m.th., të kujdesit mjekësor, të rivendosjes së dinjitetit për krimet e kryera kundër integritetit moral dhe seksual, dhe njohjes së përgjegjësisë në formën e faljes publike si dhe masat që ndërtojnë paqen dhe pajtimin e fundit.
- **E drejta e garantimit të mospërsëritjes** - shteti duhet të sigurojë qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit për të garantuar mospërsëritje. Në një mjedis pas konfliktit, kjo nënkupton verifikimin dhe largimin e zyrtarëve politik dhe të tjerë nga postet në përputhje me procesin e rregullt ligjor dhe me parimin e mosdiskriminimit, të atyre të cilët janë të implikuar drejtpërdrejt në shkeljet e të drejtave të njeriut ose që me mosveprim ose shpërfillje të detyrës nuk kanë arritur të mbrojnë apo të ndëshkojnë personat përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, ky aktivitet parashikon reformimin e ligjeve dhe të institucioneve shtetërore, duke i ndjekur normat e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin e plotë të strukturës qeverisëse me komisionet hetimore, organet kombëtare dhe hibride të drejtësisë si dhe me institucionet e sektorit të sigurisë.

V: DREJTËSIA TRANZICIONALE - PROCESET DHE MEKANIZMAT

Proceset dhe mekanizmat e mëposhtëm përfaqësojnë mekanizmat dhe aktivitetet thelbësore që lidhen me drejtësinë tranzicionale.

MEKANIZMAT E GJETJES SË FAKTEVE DHE KËRKIMIT TË SË VËRTETËS

Proceset e kërkimit të së vërtetës bazohen në "të drejtën për të vërtetën" e patjetërsueshme, duke përcaktuar që viktimat dhe komunitetet e kanë të drejtën të dinë fatin e anëtarëve të familjes ose të komunitetit të tyre. Ky aktivitet përfshin të drejtën për t'u informuar për rrethanat e shkeljeve dhe për identitetin e personave më përgjegjës. Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë, por është e dallueshme, nga detyrimi i shteteve për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht personat përgjegjës për aktet kriminale. ICTJ - International Center for Transitional Justice - QNDT - Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale thekson se: "Çdo person, i cili ka pësuar mizori, e ka të

drejtën e patjetërsueshme të dijë se kush është përgjegjës; çdo familje, anëtarët e së cilës janë zhdukur, ka të drejtë të mësojë fatin dhe vendndodhjen e tyre; çdo shoqëri, ku kanë ndodhur këto krime, ka të drejtë të mësojë historinë e saj pa gënjeshtër apo mohime".¹⁴

E drejta për të vërtetën është një e drejtë e patjetërsueshme e ndërlidhur me detyrën e shtetit për të mbrojtur të drejtat e njeriut, për të kryer hetime efektive dhe për të garantuar mjete juridike dhe dëmshpërblime efektive. Ajo është e përfshirë në instrumente ndërkombëtare siç janë Parimet dhe Udhëzimet Themelore mbi të Drejtën për Zgjidhje Efektive dhe Dëmshpërblim për Viktimat e Shkeljeve të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljet e Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.¹⁵ Nga këndvështrimi i Drejtësisë Tranzicionale, mekanizmat e kërimit të së vërtetës përfaqësojnë një qasje të përqendruar te viktimat, një qasje jo-gjyqësore, e krijuar për të inkurajuar shoqëritë që të zhvillojnë dhe të bien dakord mbi një histori të përbashkët ose memorie kolektive të një periudhe të konfliktit ose të dhunës. Ky proces gjithashtu iu ofron viktimave një platformë për t'u dëgjuar në forume zyrtare ose jozyrtare e që kontribuojnë në shërimin shoqëror dhe individual.

Trupat e kërimit të së vërtetës, të tilla si komisionet e së vërtetës, komisionet e hetimit, gjetja e fakteve dhe planifikimi ndihmojnë për të përcaktuar se çfarë ka ndodhur gjatë një periudhe specifike të dhunës ose të konfliktit, përmes organizimit të seancave publike, duke marrë deklaratat nga viktimat, nga dëshmitarët dhe nga ekspertët si dhe duke kryer kërkime të pavarura për të siguruar fakte dhe rekomandime publikisht të qasshme e me qëllim të adresimit të çështjeve të zbuluara në proces dhe për të ofruar korrigjim. Për më tepër, kërkimi i së vërtetës nëpërmjet komisioneve ose organeve të tjera mund të sigurojë një hapësirë shumë të nevojshme të sigurt për viktimat dhe për të mbijetuarit për të folur, për të raportuar dhe për të bërë të dëgjuara perspektivat e tyre për konfliktin. Komisionet e së vërtetës shpesh përfshijnë dokumentimin dhe hetimin e rasteve dhe të situatave specifike në konfliktet e kaluara me qëllim të identifikimit të nxitësve kryesor të ngjarjeve dhe të veprimeve/praktikave, të cilat kanë nxitur krimet dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.

Shtetet duhet të ndërmarrin veprimet e duhura, duke përfshirë këtu edhe masat e nevojshme për të siguruar funksionimin e pavarur dhe efektiv të gjyqësorit, për ta jetësuar të drejtën për të ditur.

KOMBET E BASHKUARA 2004

Është e një rëndësie thelbësore të njihen të vërtetat të ndryshme dhe kontradiktore në kontekstin e kërimit të së vërtetës. Ndjekjet penale, për shembull, përqendrohen në "të vërtetën" për atë sa ajo lidhet me përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe me shtrirjen dhe natyrën e provave ose të elementeve rrethore të paraqitura si argumente në procedurat gjyqësore. Argumentet dhe faktet e paraqitura në një gjykatë e kundërshtojnë njëra-tjetrën, jo domosdoshmërisht për të mbledhur ose paraqitur sasinë maksimale të informacionit ose tregimin historik të një ngjarjeje të caktuar.

Parimet e Kombeve të Bashkuara mbi pandëshkueshmërinë informojnë lidhur me zbatimin strategjik të drejtësisë tranzicionale mbi detyrimin e një shteti për të luftuar pandëshkueshmërinë dhe të drejtën për të vërtetën, në të cilën "çdo person e ka të drejtën e patjetërsueshme për të vërtetën lidhur me ngjarjet dhe rrethanat e kaluara; që kanë çuar në shkeljet sistematike dhe në kryerjen e krimeve."¹⁶

Puna e Kujtesës ose Përkujtimi (memorializimi) është tipar i ndërthurur i paraqitur si në mekanizmat e kërimit të së vërtetës, ashtu edhe në mekanizmat e dëmshpërblimeve (ose

¹⁴International Center for Transitional Justice, 14 March 2012. Right to the Truth". Marrë nga: <https://www.ictj.org/>

¹⁵Marrë nga: <https://www.ohchr.org/en/transitional-justice/truth>

¹⁶UN Commission on Human Right (2005). Updated Set of principles for the protection and promotion of human rights through action to combat impunity. Retrieved from: <http://derechos.org/nizkor/impu/principles.html>

dëmshpërblimet simbolike), pasi i referohet një vargu të proceseve dhe formave të kujtimit kolektiv. Memorialët, muzetë, monumentet dhe vendet e tjera të kujtesës përfaqësojnë vende thelbësore ku mund të bëhet ballafaqimi me të kaluarën. Në të gjithë botën, vendet e mëparshme të mizorisë, të torturës, gjenocidit, varrezat masive dhe vendndodhjet e tjera të ngjashme janë shndërruar në memorialë publikë, duke u mbështetur në mënyrë inovative në përkujtimin e Holokaustit.¹⁷ Përveç kësaj, këto vende kujtese shpesh synojnë të ofrojnë edukim/të mësuar dhe korrigjim/reflektim. Për sa i përket edukimit dhe të mësuarit social, përvoja synon të krijojë bashkëndjesi për viktimat si qenie njerëzore si dhe të sigurojë informacion në lidhje me brutalitetin e dëmit të shkaktuar ndaj tyre.

Muzetë dhe Qendrat e Dokumentimit luajnë gjithashtu një rol në përmbushjen e funksioneve të kërkimit të së vërtetës. Memorialët dhe muzetë paraqesin një rrëfim autoritativ për të kaluarën dhe shërbejnë si një depo e informacioneve dhe e burimeve parësore për një periudhë të caktuar historike. Ashtu si edhe shumë masa të drejtësisë tranzicionale, memorialët, muzetë dhe qendrat e dokumentimit mund të promovojnë shërimin social në shumë mënyra të tjera duke e nderuar jetën e viktimave dhe duke i njohur përvojat e të mbijetuarve të konfliktit si dhe duke riparuar vuajtjet e kaluara.¹⁸

Kultivimi i **"Detyrës për të ruajtur kujtesën"** lidhur me njohuritë për historinë e konfliktit është pjesë e trashëgimisë dhe, si i tillë, ky kultivim duhet të sigurohet me masat e duhura në përmbushje të detyrës së shtetit për të ruajtur arkivat, provat dhe informacionet e tjera në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtën humanitare si dhe për të lehtësuar njohjen e këtyre shkeljeve.¹⁹ Masat e tilla duhet të synojnë ruajtjen e kujtesës kolektive nga zhdukja dhe, në veçanti, mbrojtjen e

dokumenteve, të dëshmimeve të dëshmitarëve dhe të viktimave kundër argumenteve revizioniste dhe mohuese. Materialet dokumentuese nuk janë vetëm dokumente letre ose digjitale, të krijuara nga organe zyrtare ose gjyqësore, por përfshijnë gjithashtu regjistrime audio dhe video, raporte mediatike, histori të shkruara dhe përvoja personale të dëshmitarëve dhe të viktimave, si dhe prova të krimeve dhe të akteve të shpëtimit të rimëkëmbjes pas konfliktit. Dokumentimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut është jetik për ndërtimin e shoqërive paqësore dhe demokratike si dhe për pajtimin. Dokumentet mund të përbëjnë prova ligjore për të mbështetur viktimat dhe të drejtën e tyre në të vërtetën, drejtësinë dhe dëmshpërblimet dhe një bazë për pajtim dhe mjete për përcaktimin e përgjegjësisë penale të kryerësve të abuzimeve.

Jo vetëm kaq, dokumentimi është një komponent integral i angazhimit dhe aktivizmit për të drejtat e njeriut; ai ndihmon në nxitjen e përgjegjësisë për zbatimin e të drejtave të njeriut dhe për përgjegjësi më të madhe për abuzimet, ndërkohë që i parandalon mizoritë e ardhshme. Në këtë drejtim, themelimi dhe mirëmbajtja e një "Qendre të Dokumentimit", e mandatuar për mbledhjen dhe ruajtjen e kujtesës së Kosovës, duhet të ndjekë rregullin themelor "mos bëj dëm". Prandaj, është e domosdoshme që "Iniciativat e Dokumentimit" të krijohen si organe të pavarura nga

DETYRA PËR RUAJTJEN E KUJTESËS

Njohuria e një populli për historinë e shtypjes së tij është pjesë e trashëgimisë së tij dhe, si e tillë, duhet të sigurohet me masat e duhura në përmbushje të detyrës së shtetit për të ruajtur arkivat dhe provat e tjera në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare si dhe për të lehtësuar njohjen e atyre shkeljeve. Masa të tilla do të synojnë ruajtjen e kujtesës kolektive nga zhdukja dhe, veçanërisht, mbrojtjen nga zhvillimi i argumenteve revizioniste dhe mohuese.

¹⁷ Bickford, 2014

¹⁸ Transitional Justice Tools: Truth Seeking - United States Holocaust ..., <https://www.ushmm.org/genocide-prevention/simon-skjodt-center/work/ferencz-international-justice-initiative/transitional-justice/truth-seeking>

¹⁹ INTERNATIONAL COUNCIL ON ARCHIVES HUMAN RIGHTS WORKING GROUP ... - ICA.

https://www.ica.org/sites/default/files/ICA%20HRWG%20Basic%20Principles_endorsed%20by%20PCOM_2016_Sept_English.pdf

institucionet shtetërore apo ato politike me qëllim të ruajtjes së integritetit të plotë dhe për të ofruar qasje publike. Në vitin 2008, një konsorcium i organizatave të shoqërisë civile nga vendet e rajonit e ka themeluar Komisionin Rajonal të së Vërtetës (KOMRA) për të konstatuar faktet në lidhje me krimet e kryera të luftës, numrin e njerëzve të vrarë dhe të atyre që janë zhdukur ose janë mbajtur në burgje ose në kampe të ndalimit gjatë konfliktit. Përveç kësaj, KOMRA ka nisur disa aktivitete për përfshirjen e drejtësisë tranzicionale në procesin e integritetit në BE.

KOMISIONI I SË VËRTETËS DHE I PAJTIMIT I KOSOVËS

Në vitin 2017, presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, ka inicuar Themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit. Në vitin 2018 është krijuar një ekip parapërgatitor për të përgatitur legjislacionin për krijimin e Komisionit. Mirëpo, në nëntor të vitit 2020, Hashim Thaçi dha dorëheqjen dhe me këtë edhe puna në Komisionin ka ngecur. Megjithatë, gjatë kohës që ekipi parapërgatitor ka funksionuar, ata kanë hartuar një projekt-akt normativ gjithëpërfshirës për Komisionin e së Vërtetës dhe Pajtimit, me synim krijimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimit (Komisioni)²⁰, i cili do të dokumentojë dhe vërtetojë faktet mbi shkeljet e të drejtave të njeriut, të cilat kanë ndodhur në të kaluarën e afërt, duke ua kthyer dinjitetin viktimave dhe të mbijetuarve, me qëllimin për të kontribuar në transformimin social e me qëllim të kapërcimit të pasojave të shkeljeve dhe të abuzimeve të pësura si dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre; duke e synuar krijimin e Komisionit me pavarësi të plotë, pa asnjë ndikim politik apo tjetër, i cili do të veprojë lirshëm, pa ndikim apo kontroll të drejtpërdrejtë të ndonjë institucioni apo mekanizmi vendor apo ndërkombëtar, pavarësisht nga mbështetja që mund të ofrojnë ato.

SKDT duhet të ketë parasysh mundësinë e krijimit të një Komisioni të tillë të së Vërtetës dhe Pajtimit dhe të përfitojë nga puna tashmë e bërë nga grupi parapërgatitor, veçanërisht nga projekt-akti normativ, i cili ofron një bazë të mirë për ngritjen e një Komisioni të tillë.

KOMRA – Koalicioni Rajonal për të Vërtetën dhe Pajtimin. Procesi i KOMRA-s ka filluar në vitin 2006 si koalicioni i parë dhe më i suksesshëm rajonal i krijuar si një organ kërkimor i së vërtetës i përbërë nga 6700 përfaqësues të shoqërisë civile, duke përfshirë këtu organizatat për të drejtat e njeriut, viktimat, familjet e viktimave dhe të të zhdukurve, refugjatët, veteranët/mbrojtësit, ish të burgosur, avokatë, artistë, shkrimtarë, gazetarë dhe individë të tjerë të dalluar nga e gjithë ish-Jugosllavia. Janë mbajtur njëqind e njëzet e tetë samite lokale dhe rajonale dhe tetë forume ndërkombëtare për drejtësinë tranzicionale. Mendimet e paraqitura janë inkorporuar në Statusin e propozuar të KOMRA-s, të miratuar më 26 mars të vitit 2011 nga Kuvendi i Koalicionit për KOMRA-n²¹. Pos kësaj, mbi gjysmë milioni qytetarë nga ish-Jugosllavia i kanë nënshkruar peticionet që bënin thirrje për një komision rajonal të së vërtetës. Fatkeqësisht, procesi ka ngecur për shkak të mungesës së miratimit nga elitat politike; megjithatë, iniciativa KOMRA është e gatshme të rifillojë aktivitetet dhe të rivendosë mandatin e saj sipas kërkesave të shteteve pjesëmarrëse.

SFIDAT DHE KONSIDERATAT

E drejta për të ditur - përfshin të drejtën për të mësuar të vërtetën për fatin e personave të zhdukur. Në vitin 2019, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Zhdukjet e Dhunshme nxori Parimet Udhëzuese për Kërkimin e Personave të Zhdukur dhe Rezolutën 2474 të Këshillit të Sigurimit,²² e para e këtij lloji që u drejtohet personave të zhdukur. Në të njëjtin vit, Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur,KNPZH, ka prezantuar Parimet e saj të Parisit²³, të cilat "reflektojnë dhe avancojnë një konsensus global në zhvillim e sipër lidhur me atë se si të trajtohet çështja e personave të zhdukur. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, KNKK, në mënyrë të ngjashme e

²⁰(https://president-ksgov.net/repository/docs/2020_01_28_103348_Normative_Act_eng_for_web_jan2020.pdf).

²¹ INTERNATIONAL COUNCIL ON ARCHIVES HUMAN RIGHTS WORKING GROUP ... - ICA.

https://www.ica.org/sites/default/files/ICA%20HRWG%20Basic%20Principles_endorsed%20by%20PCOM_2016_Sept_English.pdf

²²Protection of civilians in armed conflict - Missing persons in armed conflict. <http://unscr.com/en/resolutions/2474>

²³ ICMP, Paris Principles, <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2019/04/icmp-dg-1468->

tërheq vëmendjen për familjet e të zhdukurve në botimin e tij të vitit 2020, Shoqërimi i Familjeve të Personave të Zhdukur: Një Manual Praktik²⁴.

Në këtë drejtim, aktivitetet e Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH – Serbi dhe Kosovë) për të hulumtuar dhe për të dokumentuar humbjet njerëzore, krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut janë një proces i njohur ndërkombëtarisht, që përbënë një shembull të shkëlqyer të një kërkimi rrënjësor në terren për të mbështetur "Të drejtën për të ditur." Projekti në vazhdim, Libër Kujtimi i Kosovës i FDH-së, ka regjistruar dhe vërtetuar fakte të padiskutueshme duke renditur emrat dhe rrethanat e lidhura me vdekjen e 13,500 viktimave²⁵.

Së këndejmi, "E drejta për të ditur" i fuqizon individët dhe komunitetet, duke iu mundësuar atyre të marrin pjesë në vendime dhe në procese që i prekin ata, duke i mbajtur gjithashtu qeveritë dhe të tjerët përgjegjës.²⁶ SKDT duhet të institucionalizojë procedurat në mënyrë që qytetarët të kenë qasje në informacion në lidhje me fatin e personave të zhdukur dhe informacion mbi aktivitetet e autoriteteve shtetërore për të marrë informacion nga shtetet fqinje. Në këtë drejtim, të gjitha proceset dhe afatet kohore për adresimin e personave të zhdukur duhet të jenë pa kufizime statutores, pa kufizime në aspektin e afateve kohore, apo pa interpretime të ligjeve apo veprimeve që mund të perceptohen si diskriminuese ose kufizuese në lidhje me të drejtat e qytetarëve. Për më tepër, pavarësisht nga përkatësia etnike apo rrethanat e vdekjes, autoritetet duhet ta pranojnë humbjen njerëzore.

MEMORIALËT DHE KOMEMORIMET²⁷

Procesi i përkujtimit lidhet drejtpërdrejt me shtetin dhe qëllimin për të siguruar përgjigjen e kënaqshme lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe për të mbrojtur kujtesën historike, për të nderuar viktimat, për të parandaluar mohimin, revizionizmin dhe mohimin e së kaluarës si dhe për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në përgjithësi, memorialët shkaktojnë reagime emocionale dhe katartike dhe japin informacion për një ngjarje të caktuar historike. Megjithatë, drejtësia tranzicionale ofron gjithashtu mundësinë që memorialët të kenë një funksion pedagogjik përmes edukimit dhe zgjerimit të dialogut social mbi ngjarjet ose paraqitjet e memorialit ose përkujtimit dhe lidhjes së tij me zhvillimet bashkëkohore shoqërore dhe politike.

Në Kosovë ka tendencë për vendosjen e monumenteve në kujtim të ngjarjeve dhe të individëve që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur. Megjithatë, shumica janë aktivitete të koordinuara në mënyrë joadekuate nën legjislacionin joefektiv dhe angazhimin publik. Ekziston gjithashtu një të kuptuar i kufizuar në Kosovë për çështjen e memorialëve në kontekstin e efekteve të mundshme negative dhe lidhur me polarizimin e popullatave të prekura. Për shembull, shumica e memorialëve janë paraqitje fizike statike të ngjarjeve, me një funksion të theksuar emocional dhe shpesh me karakteristika të shenjta, kurse funksioni pedagogjik i memorialëve mbetet i padukshëm. Në këtë drejtim, memorialët vazhdojnë të gjenerojnë debate kundërthënëse në shoqërinë kosovare.

Duke nxitur një qasje nga poshtë lart, koalicioni KOMRA është riorganizuar për të formuar një rrjet rajonal të palëve të interesuara të shoqërisë civile me qëllim të adresimit të nevojave të komuniteteve lokale për kërkimin e së vërtetës dhe për dokumentimin e fakteve në lidhje me konfliktet në ish-Jugosllavi. Libri i Kujtimit i Kosovës është një iniciativë e tillë, e cila është monument për viktimat e krimeve të luftës (civilët, të plagosurit dhe robërit e luftës), të vrarët në betejë (ushtarët) dhe të zhdukurit me forcë në Kosovë në periudhën prej datës 1 janari të vitit 1998 e

²⁴Accompanying the Families of Missing Persons: A Practical Handbook, <http://shop.icrc.org/accompanying-the-families-of-missing-persons-a-practical-handbook-pdf-en>

²⁵ As of May 2022.

²⁶ UNESCO, Freedom of information: the right to know; 2011, p. 16.

²⁷ Megjithëkëtë, procesi i ruajtjes së kujtesës historike është shumë më kompleks se sa grupimi i saktë në cilëndo prej mekanizmave të drejtësisë tranzicionale, për arsye se memorializimi i kontribuon proceseve të tjera po ashtu, siç është tregimi i së vërtetës, mbrojtja e vlerave demokratike dhe respekti për të drejtat e njeriut, ndërtimi i besimit në institucionet qeveritare, ruajtja e paqes, ndërtimi i relacioneve të reja dhe ripërtëritja e relacioneve të vjetra, pajtimi etj.

deri në muajin dhjetor të vitit 2000 gjatë konfliktit të armatosur ndërmjet policisë serbe dhe Ushtrisë Jugosllave, në njërin anë, dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nga ana tjetër. Ai i nxit njerëzit të kujtojnë viktimat duke ofruar fakte të padiskutueshme si dëshmitari më i besueshëm i së kaluarës së Kosovës, duke zëvendësuar shifrat e viktimave me emrat e të vrarëve ose të të zhdukurve.

Rreziqet - Është thelbësore të zbuten rreziqet që lidhen me përpjekjet për kërkimin e së vërtetës, pasi ato mund të rindezin konfliktin duke i penguar njerëzit të ecin përpara nga e kaluara. Të tjerët kanë vënë në dukje se regjimet autokratike mund të kooptojnë përpjekjet e kërkimit të së vërtetës për të fabrikuar historinë ose për të krijuar versione të historisë që iu shërbejnë vet atyre. Ashtu si edhe të gjitha masat e drejtësisë tranzicionale, masat e kërkimit të së vërtetës duhet të hartohen duke u shoqëruar me masa mbrojtëse për të garantuar pavarësinë, legjitimitetin, gjithëpërfshirjen dhe besueshmërinë. Prandaj, konsultimi dhe përfshirja e grupeve të ndryshme të viktimave dhe të komuniteteve të prekura gjatë procesit të kërkimit të së vërtetës është e një rëndësie të madhe.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

- 1 Forcimi dhe mbështetja e iniciativave ekzistuese dhe të reja të shoqërisë civile për gjetjen e fakteve dhe tregimin e së vërtetës duke krijuar një platformë për dialog dhe ndërveprim të ndërsjellë në nivel kombëtar dhe rajonal e me qëllim të sigurimit të funksionimit efektiv dhe kontribut cilësor në proces. Kjo e përfshin njohjen dhe asimilimin e “fakteve të gjykuara” përpara organeve gjyqësore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare.
- 2 Krijimi i mekanizmave institucional të gjetjes së fakteve dhe të tregimit të së vërtetës, si një “komision i së vërtetës” për të hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut në vitet 1998-1999 dhe pasojat e konfliktit deri në fund të vitit 2000, në mënyrë plotësuese me mekanizmat ekzistues gjyqësorë dhe jo-gjyqësorë.
- 3 Vendosja e udhëzimeve dhe e standardeve të rrepta për memorialët dhe aktivitetet përkujtimore përmes legjislacionit dhe politikave të përshtatshme.
- 4 Përforcimi i kapacitetit dhe i iniciativave politike dhe teknike në kërkimin e personave të zhdukur, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave ligjërisht të detyrueshme, të harmonizuara dhe të mbrojtura për të gjitha viktimat e shkeljeve të të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe të së drejtës humanitare.²⁸
- 5 Sigurimi i “të drejtës për të vërtetën” përmes qasjes së papenguar në informata për rastet e krimeve të luftës në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Kosova ka dështuar për të ofruar një qasje gjithëpërfshirëse për gjetjen e fakteve dhe tregimin e së vërtetës. Siç u tha më lart, institucionet gjyqësore ndërkombëtare dhe kombëtare kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në vërtetimin e fakteve për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera gjatë periudhës 1998-2000; megjithatë, këto kontribute janë të kufizuara nga fokusi i qenësishëm i procesit gjyqësor për të vendosur përgjegjësinë penale individuale. Lidhur me këtë, gjykatat gjykojnë fakte të përqendruara në ngjarje të veçanta të aktakuzës, ndërsa ngjarjet, (“Shkaqet rrënjësore” apo pse ndodhi ngjarja në radhë të parë) mbeten jashtë fokusit të gjykimeve penale.

²⁸Organizatave e shoqërisë civile, siç është Qendra për të Drejtën Humanitare e Kosovës, duhet të këshillojë këtë proces.

Për të gjitha këto arsye, SKDT duhet të ketë parasysh krijimin e një mekanizmi institucional, jo-gjyqësor, i cili fokusohet te viktimat dhe nevojat e tyre (ndryshe nga proceset gjyqësore që fokusohen në llogaridhënie) për të parandaluar mohimin e krimeve të kryera të luftës, mohimin dhe revizionizmin historik.

MEKANIZMAT PËR DREJTËSI

E drejta në drejtësi - Shtetet janë të detyruara të hetojnë, të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë në mënyrë të përshtatshme individët përgjegjës për shk-

eljet e ligjit dhe të të drejtave të njeriut. Gjykimet penale mund të mbështesin sundimin e ligjit, të demonstrojnë se mosndëshkimi për shkeljen e të drejtave të njeriut nuk do të tolerohet si dhe të pengojnë shkeljet e ardhshme duke i ndëshkuar ata që janë më së shumti përgjegjës. Pos kësaj, provat e paraqitura dhe të gjykuara në një proces gjyqësor mund të ndihmojnë në krijimin e shënimeve historike lidhur me mizoritë dhe të luftojnë mohimet nga viktimizuesit dhe aleatët e tyre politik që mizori të tilla kanë ndodhur ndonjëherë. Së fundi, procedurat penale gjithashtu arrijnë të drejtën e viktimës për drejtësi dhe ndihmojnë në rivendosjen e dinjitetit të viktimave dhe familjeve të tyre duke i pranuar publikisht gabimet e bëra ndaj tyre.

E drejta në drejtësi nënkupton që viktimat mund të kërkojnë të drejtat e tyre dhe të marrin një mjet juridik të drejtë dhe efektiv, duke përfshirë pritshmërinë që personi ose personat përgjegjës do të mbahen përgjegjës me mjete gjyqësore dhe se dëmshpërblimi do të jetë i afërt.²⁹ E drejta për drejtësi është detyrim i shtetit ndaj viktimave të krimit për të hetuar shkeljet, për të arrestuar dhe për të ndjekur penalisht kryerësit e krimeve dhe, nëse vërtetohet fajësia, të vendosë sanksione për krimet.

Gjykatat kombëtare kanë përgjegjësinë parësore për të ushtruar juridiksionin dhe gjykatat penale ndërkombëtare ose hibride mund të ushtrojnë juridiksion të njëkohshëm sipas kushteve të statuteve të tyre dhe marrëveshjes me shtetin me juridiksion parësor. Megjithatë, pavarësisht nga rëndësia e tyre, vetëm ndjekjet penale nuk janë të mjaftueshme për të korrigjuar plotësisht mizoritë dhe për të rivendosur sundimin e ligjit. Prandaj, për të formuar një strategji gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale, gjykimet penale duhet të përplotësojnë mekanizmat e tjerë të drejtësisë tranzicionale, siç janë reparacionet, kërkimi i së vërtetës dhe reformat institucionale.

Shumica e përpjekjeve për t'u marrë me të kaluarën e kohës së luftës në Kosovë janë fokusuar në ndjekjen penale të krimeve të luftës pa investuar shumë në mekanizmat e tjerë të drejtësisë tranzicionale për të mbështetur shoqërinë që të lëvizë drejt një të ardhmeje më paqësore. Gjykatat e mëparshme ndërkombëtare, dhe gjykatat vendore në Kosovë dhe në Serbi, kanë arritur të ndjekin penalisht vetëm një numër relativisht të vogël të krimeve të rënda. Si rezultat, ato nuk i përmbushën pritshmëritë e shumë viktimave dhe nuk kanë bërë shumë për të rivendosur besimin në proceset e drejtësisë mes qytetarëve. Për më keq, në Kosovë dhe Serbi, të dyshuarit e liruar ose kryerësit e krimeve të dënuar konsiderohen si heronj dhe shumë prej tyre kanë arritur të qëndrojnë ose të kthehen në pozitat e pushtetit politik. Nga të dyja anët, diskursi politik nationalist është i kornizuar në mënyrë dramatike nga kjo e kaluar e kohës së luftës, e cila përcakton rrëfimet ekskluzive të viktimave dhe kryerësve të krimeve.

Dhoma e Apelit ka konsideruar se faktet e gjykuara janë konstatuar në një procedure midis palëve të tjera në bazë të provave, të cila palët në procedure janë përcaktuar për të futur, në kontekstin e caktuar të asaj procedure.

²⁹Shih po ashtu preambulën e Basic Principles and Guidelines on reparation (Parimet themelore dhe udhëzimet mbi reparacionet) të cituar lidhur me këtë. A Conceptual Framework for Dealing with the Past Politorbis Nr. 50 - 3 / 2010

SFIDAT DHE KONSIDERATAT

Proceset gjyqësore duhet të jenë të pavarura dhe të paanshme pavarësisht nga përkatësia politike, pozita e autoritetit ose përkatësia etnike e të akuzuarit. Përveç kësaj, procedimi duhet të përfshijë garanci procedurale për integritetin e procesit, duke siguruar të drejtat e të akuzuarve për një gjykim të drejtë dhe qasje në drejtësi për viktimat. Pesë konsiderata udhëzuese duhet të zbatohen për të gjitha nismat prokuroriale (qoftë vendore apo me asistencë ndërkombëtare): SKDT duhet të kërkojë të përfshijë parimet e mëposhtme:

- Të përforcoj mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimës/dëshmitarit. Të institucionalizojë zero-tolerancë dhe dënime adekuate për frikësimin ose dëmtimin e viktimave, të dëshmitarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në proceset gjyqësore. Kërcënimet ndaj viktimave dhe dëshmitarëve janë jashtëzakonisht të larta në mjediset e brishta të tranzicionit. Prandaj, ndërtimi i kapaciteteve institucionale për të mbrojtur dëshmitarët dhe viktimat në një mënyrë të përshtatshme gjinore dhe të ndjeshme ndaj moshës është thelbësor për të garantuar pavarësinë dhe integritetin e procesit gjyqësor dhe për të mbrojtur të drejtat e viktimave dhe të pjesëmarrësve të tjerë. Forcimi i mbështetjes për viktimat dhe dëshmitarët në rastet e krimeve të luftës përfshin forcimin e kapaciteteve të qendrave të mirëqenies sociale, qendrave për shëndetin mendor dhe OSHC-të dhe mekanizmat e referimit³⁰. Prandaj, SKDT duhet të shtojë fokus plotësues në rehabilitimin si një formë e reparacioneve. Objektivi i saj strategjik është të krijojë një sistem referimi të qëndrueshëm për të ofruar shërbime të vazhdueshme dhe efektive psikosociale për viktimat dhe për personat e tjerë në procese gjyqësore në nevojë. Ky sistem nënkupton rrjetëzimin e institucioneve që ofrojnë shërbime psikosociale, si klinikat universitare, repartet psikiatrike të spitaleve, qendrat për shëndetin mendor, qendrat e mirëqenies sociale, si dhe OSHC-të në sisteme ku mund të kërkojnë referime nga organet e zbatimit të ligjit, gjyqësori dhe institucione apo grupe të tjera për shërbime për të mbështetur personat që kanë nevojë për kujdes të specializuar.
- Të sigurojë pavarësinë dhe paanshmërisë – Proceset gjyqësore duhet të jenë të pavarura dhe të paanshme pavarësisht nga përkatësia politike, pozita e autoritetit ose përkatësia etnike e të akuzuarit. Procedimi duhet të përfshijë garanci procedurale për integritetin e procesit, duke siguruar të drejtat për një gjykim të drejtë dhe qasje në drejtësi për viktimat. Gjykimi i krimeve të mizorisë mund të jetë veçanërisht sfidues në mbledhjen e provave, disponueshmërinë e të akuzuarit, kostot dhe kohëzgjatjen e procedimit.
- Të rris kapacitetet dhe aftësitë. Hetimi dhe ndjekja penale e krimeve mizore janë komplekse, dhe, si të tilla, kërkojnë hetues, gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë mbrojtës me njohuri dhe aftësi të specializuara.
- Të menaxhojë pritshmëritë dhe të lidh proceset e DT – Pasi procedura penale do të procedojë vetëm një numër të kufizuar të krimeve të kryera në Kosovë³¹. Prandaj, autoritetet gjyqësore dhe palët e interesuara shtetërore duhet të menaxhojnë pritshmëritë e viktimave, të dëshmitarëve dhe të publikut përmes aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe informuese për të siguruar që proceset gjyqësore dhe rezultatet e tyre të kuptohen plotësisht. Në këtë drejtim, informacioni në lidhje me gjykimin e rasteve të krimeve të luftës, duke përfshirë transkriptet dhe gjetjet gjyqësore, duhet të jetë në dispozicion publikisht.

³⁰ Refferals -

³¹INTERNATIONAL COUNCIL ON ARCHIVES HUMAN RIGHTS WORKING GROUP ... - ICA.

https://www.ica.org/sites/default/files/ICA%20HRWG%20Basic%20Principles_endorsed%20by%20PCOM_2016_Sept_English.pdf

- Përforcimi i bashkëpunimit rajonal – Gjykimet e krimeve të luftës para gjykatave kombëtare kërkojnë një nivel të lartë bashkëpunimi ndërshtetëror për shkak të natyrës ndërkufitare të konflikteve. Viktimat, dëshmitarët, kryerësit e krimeve dhe provat nuk janë të disponueshme në një juridiksion të vetëm kombëtar. Për më tepër, të gjitha shtetet pasardhëse të Jugosllavisë kanë ndalime kushtetuese për ekstradimin e shtetasve të tyre për t'u përballur me gjyqe në vende të tjera. Në këtë drejtim, gjykimi i krimeve të luftës është i pamundur pa bashkëpunim efektiv rajonal.³²
- Të eliminojë “Gjykimet në mungesë” - Ndryshimi i vitit 2019 në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës i lejon gjykimet në mungesë në rastet që përfshijnë veprat kundër të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe kundër ligjit ndërkombëtar penal të kryera ndërmjet janarit të vitit 1998 dhe qershorit të vitit 1999. Megjithatë, gjykimet në mungesë mbeten një çështje kontraverze në Kosovë për shkak të pretendimeve të krimeve të luftës dhe marrëdhënieve sfiduese ndërmjet autoriteteve serbe dhe kosovare, duke penguar bashkëpunimin në çështjet e përgjithshme dhe në ato penale. Pavarësisht nga legjislacioni mbështetës dhe hendeku i mosndëshkimit që ekziston në ndjekjen e krimeve të luftës, shoqëria civile ka argumentuar kundër zhvillimit të gjykimeve në mungesë në Kosovë, duke e favorizuar bashkëpunimin më të ngushtë me shërbimet rajonale të prokurorisë në Serbi, në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe krijimin e një mekanizmi të bashkëpunimit që çështjet të procedohen në juridiksionet ku i akuzuari është rezident. Kundërshtarët e gjykimeve në mungesë argumentojnë më tej se gjykimet në mungesë do të politizonin më tej procedurat gjyqësore, duke hedhur dyshime mbi besueshmërinë e vetë procesit. Prandaj, gjykimet në mungesë e komprometojnë aftësinë e të akuzuarit për të ushtruar të drejtat e tij/saj për një gjykim të drejtë dhe të drejtat e viktimës për drejtësi dhe kompensim.
- Të sigurojë monitorimin e procedurave gjyqësore dhe qasje të papenguar në dosjet dhe në dokumentacionin gjyqësor. Qëllimi kryesor i monitorimit të gjykimeve të krimeve të luftës është forcimi i sundimit të ligjit në procedurat e krimeve të luftës përmes rritjes së efikasitetit dhe duke përmirësuar kuadrin ligjor për procedurat e krimeve të luftës si dhe duke përmirësuar statusin e viktimës në procedurë. Prandaj, është e domosdoshme që monitorimi i proceseve gjyqësore të shihet si një element integral dhe mbështetës në zbatimin e drejtësisë.

REPARACIONET

E drejta në reparacione - Viktimat kanë të drejtë për mjete juridike dhe dëmshpërblime. E themeluar në të drejtën ndërkombëtare dhe në konventat e të drejtave të njeriut, kjo e drejtë i referohet masave për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të njeriut duke ofruar përfitime materiale dhe simbolike për viktimat, për familjet e tyre dhe komunitetet e prekura. Dëmshpërblimi duhet të jetë adekuat, efektiv, i shpejtë dhe proporcional me peshën e shkeljeve dhe të dëmit të pësuar. Palët shtetërore duhet të sigurojnë që individët të kenë mjete juridike dhe dëmshpërblime të qasshme, efektive dhe të detyrueshme, si udhëzim i përgjithshëm.

Parimet Themelore të OKB-së mbi të Drejtën e Mjetit Juridik dhe Dëmshpërblimet e theksojnë "fuqinë katalitike që mund të kenë mjetet juridike të vërteta dhe dëmshpërblimet" në jetën e ardhshme të viktimave, të familjeve dhe shoqërive të tëra", duke përforcuar dëmshpërblimet që duhet të synojnë t'i rikthejnë viktimat në gjendjen e tyre para konfliktit, në gjendjen para dhunës.

³²Për shkak të rëndësisë së luftimit kundër mosndëshkueshmërisë për krimet e luftës, bashkëpunimi rajonal është një nga zotimet kyçe, që Kroacia, Serbia, B dhe H dhe Mali i Zi e kanë ndërmarrë si pjesë të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE)

³³OHCHR | Reparations. <https://www.ohchr.org/en/transitional-justice/reparations>

Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (ICTJ) ka përcaktuar më tej se reparacionet "njojnë detyrimin ligjor të një shteti, ose individ(ve) ose grupi, për të riparuar pasojat e shkeljeve – qoftë për shkak se i ka kryer drejtpërdrejt ose nuk i ka parandaluar ato. Ato, parimet, gjithashtu ua shprehin viktimave dhe shoqërisë në përgjithësi se shteti është i përkushtuar për të adresuar shkaqet rrënjësore të shkeljeve të së kaluarës dhe për të siguruar që ato të mos përsëriten më. Me përfitimet e tyre materiale dhe simbolike, dëmshpërblimet janë të rëndësishme për viktimat, sepse ato shpesh shihen si mënyra më e drejtpërdrejtë dhe më kuptimplote për marrjen e drejtësisë. Megjithatë, ato janë shpesh masa e drejtësisë tranzicionale më së paku e zbatuar dhe më pak e financuar."³⁴

Një parim udhëzues është që shteti të sigurojë një "standard jetese" të barabartë ose të krahasueshëm me atë në shoqëritë, të cilët nuk kanë vuajtur nga konflikti. Për shembull, sigurimi i të ardhurave të sigurta, strehimi, kujdesi shëndetësor dhe arsimimi përfaqësojnë një standard të pragut të kujdesit. Për më tepër, është e rëndësishme të plotësohet kompensimi [financiar] me lloje të tjera

të dëmshpërblimeve, siç është rivendosja e të drejtave civile dhe politike, ndryshimi i dënimeve të padrejta penale, largimi i padrejtë nga puna ose arsimimi, rehabilitimi fizik dhe rideklarimi i pronës, kujdesi shëndetësor, lirimi nga shpifjet. Së fundi, këto masa iu ofrohen anëtarëve të familjes së viktimave, shpesh fëmijëve, në njohjen e faktit se sigurimi i tyre me një të ardhme më të mirë është thelbësor për tejkalimin e pasojave të qëndrueshme të shkeljeve, duke dërguar një mesazh të rëndësishëm përmes pohimit se viktimat janë anëtarë të vlerësuar të komunitetit.

Në këto situata, dëmshpërblimet duhet të hartohen dhe të zbatohen në atë mënyrë që ato mund të transformojnë marrëdhëniet e mëparshme të pabarabarta dhe të padrejta – të lidhura me mjete të tjera të drejtësisë tranzicionale, si dhe në atë mënyrë që dëmshpërblimet mund të ndihmojnë në zbulimin e të vërtetës për vetë shkeljet dhe të japin garanci se ato nuk do të përsëriten. Dëmshpërblimet simbolike³⁵ mund të jenë po aq të dobishme, shëruese dhe domethënëse sa edhe dëmshpërblimet materiale. Dëmshpërblimet simbolike mund të përfshijnë, ndër të tjera, faljet zyrtare, riemërtimin e hapësirave publike, vendosjen e ditëve të përkujtimit dhe krijimin e muzeve dhe të hapësirave publike, siç janë parqet kushtuar kujtimit të viktimave. Naomi Roht-Arriaza³⁶ i referohet këtyre si dëmshpërblime morale që përfshijnë ndihmën në rivaarrosjet publike dhe ritualet e duhura, dhënien përparësi kërkimit të mbetjeve njerëzore dhe shndërrimin e vendeve të represionit në vende kujtimi dhe të homazheve për viktimat.

SFIDAT DHE KONSIDERATAT

Programet e reparacioneve³⁷ - Shtetet janë të detyruara të ofrojnë dëmshpërblime materiale dhe jomateriale, të cilat kanë efekte individuale dhe shoqërore. Ato kontribuojnë në rivendosjen e dinjitetit të viktimave, në njohjen dhe në pranimin e dëmit të pësuar, në tejkalimin e pasojave të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe në përmirësimin e statusit të tyre socio-ekonomik për të arritur ri-integrimin e tyre social.

Ekzistojnë pesë forma themelore të programeve të dëmshpërblimeve³⁸, 1. Kompensimi zbatohet

³⁴<https://www.ictj.org/>

³⁵Gender, Memorialization, and Symbolic Reparations, <https://www.cambridge.org/core/books/abs/gender-of-reparations/gender-memorialization-and-symbolic-reparations>

³⁶Roht-Arriaza, Naomi. "Reparations Decisions and Dilemmas," *Hastings International and Comparative Law Review* 27, no. 2 (2004) Google Scholar.

³⁷Në teorinë e drejtësisë tranzicionale, memorialët shpesh grupohen nën dëmshpërblime simbolike dhe kolektive. Megjithatë, procesi i ruajtjes së kujtesës historike është shumë më kompleks sesa grupimi i tij në ndonjë nga mekanizmat e drejtësisë tranzicionale pikërisht sepse përkujtimi kontribuon edhe në procese të tjera, si tregimi i së vërtetës, mbrojtja e vlerave demokratike dhe respektimi i të drejtave të njeriut, ndërtimi i besimit, në institucionet qeveritare, ruajtja e paqes, ndërtimi i të rejave dhe rivendosja e marrëdhënieve të vjetra shoqërore, pajtimi, etj.

³⁸Sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare, një viktimitë e shkeljeve të rënda të ligjit të të drejtave të njeriut do të ketë qasje të barabartë në një mjet juridik efektiv si dhe ndaj dëmshpërblime. Mjetet e tjera juridike në dispozicion të viktimitës e përfshijnë qasjen në organet administrative dhe në organet e tjera, mekanizmat, modalitetet dhe procedurat e kryera sipas legjislacionit vendas.

për të mbuluar çdo dëm fizik ose jo-fizik ekonomikisht të vlerësueshëm - të dhënë nëpërmjet vendimeve administrative dhe gjyqësore; 2. Rikthimi përbëhet nga aktivitete të ndryshme për rikthim të të drejtave qytetarëve. Qëllimi kryesor është kthimi i viktimës në gjendjen fillestare, në të cilën viktimat ishte përpara shkeljeve të të drejtave të njeriut; dhe 3. Rehabilitimi përfshin kujdesin mjekësor dhe psikologjik si dhe qasjen në drejtësi dhe shërbime ligjore; 4. Kënaqësia përfshin forma simbolike si kërkimi i faljes, krijimi i monumenteve dhe memorialeve dhe vendosja e fakteve për të kaluarën. 5. Garancitë e mospërsëritjes - reforma e institucioneve, në radhë të parë e institucioneve gjyqësore dhe të zbatimit të ligjeve dhe një kuadër i ri legjislativ për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

- 1** Të mbështes të drejtat e viktimave për dëmshpërblime, duke përfshirë njohjen e përgjegjësisë, kornizën kohore për pranueshmërinë, një përcaktim dhe kategorizim të qartë të të drejtave dhe të llojeve të dëmshpërblimeve, afatin kohor për administrimin e reparacioneve, burimet dhe shpërndarjen e financimit. Legjislacioni duhet të tregojë gjithashtu institucionet përgjegjëse për dëmshpërblimin si dhe organet përgjegjëse për ofrimin e mbikëqyrjes.
- 2** Të sigurohet që programet e dëmshpërblimit të përfshijnë forma të ndryshme përtej kompensimit, të tilla si masat e kënaqësisë, të kthimit dhe të rehabilitimit si dhe garancitë për mospërsëritje; në shkallën, në të cilën masat janë të dizajnuara dhe të afta për t'i rikthyer viktimat në gjendjen e tyre fillestare përpara se të ndodhnin shkeljet, që është rivendosja e lirive, e punësimit, e pronës dhe e dëmeve morale, siç përkufizohet në dokumentin udhëzues.
- 3** Të sigurohet se reparacionet zbatohen në mënyrë të barabartë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë përfituesit, të lidhura me proceset afatgjata të zhvillimit. Për këtë qëllim, është thelbësore të krijohet një bazë e unifikuar dhe e kategorizuar e të dhënave e të gjithë përfituesve, pavarësisht nga të drejtat ose lloji i kompensimit dhe t'i bëjnë këto të dhëna të qasshme për shqyrtim publik sipas ligjeve dhe procedurave të mandatuara për mbrojtjen e të dhënave.
- 4** Të sigurohet pranimi i shkeljeve, mbështetja për kërkimin e së vërtetës, kërkimi e personave të zhdukur, gjetja/rivarrimi i mbetjeve njerëzore, kërkimi i faljeve publike dhe ngritja e memorialëve dhe përkujtimet.
- 5** Rritja e ndërgjegjësimin dhe shpërndarja e informacionit, nëpërmjet objekteve të përshtatshme ligjore, diplomatike, konsullore dhe mekanizmave publik dhe privat, informacion për të gjitha programet në dispozicion lidhur me dëmshpërblimin dhe të drejtat e individëve dhe të komuniteteve për këto të drejta. Marrja e masave të duhura për të minimizuar procedurat administrative, për t'u mbrojtur kundër ndërhyrjeve të paligjshme në privatësi, për të ofruar shërbime ligjore dhe shërbime të tjera për viktimat që kërkojnë qasje në dëmshpërblime.

PAJTIMI

Në drejtësinë tranzicionale - pajtimi kuptohet si një proces dhe si një qëllim, i cili e përfshin "njohjen reciproke të një të kaluarë të përbashkët dhe transformimin e marrëdhënieve dhe të sjelljeve të dëmshme për të promovuar një të ardhme të përbashkët drejt paqes së qëndrueshme". Prandaj, pajtimi përfshin njohjen e plotë të padrejtësive të së kaluarës, të propozuara për të krijuar një bazë

për rindërtimin e marrëdhënieve midis ish-armiqve, të karakterizuar nga e vërteta, njohja e ndërsjellë dhe përgjegjësia, "duke sjellë së bashku individë, grupe dhe shoqëri të ngarkuara nga konfliktet e kaluara ose të tashme dhe përfaqësimet dhe perceptimet negative të "tjetrit". E vërteta dhe drejtësia nevojiten për të rindërtuar besimin si në nivelin ndërpersonal, ashtu edhe në atë shoqëror. Së këndejmi, pajtim nuk do të thotë të harrosh apo të braktisësh të kaluarën, as nuk kërkon falje apo mëshirë. Në vend të kësaj, në nivel individual dhe në atë të komunitetit, pajtim do të thotë të mësosh nga e kaluara dhe të ndryshosh qëndrimet dhe sjelljet për të siguruar më mirë respektin e ndërsjellë dhe kohezionin e qëndrueshëm social.

Pajtimi është një nga objektivat primare të drejtësisë tranzicionale, ngaqë e sheh pajtimin si një proces i cili e mundëson ripërtëritjen e marrëdhënieve sociale mbi bazat e vlerave fundamentale, siç janë dinjiteti i njeriut, respekti, e drejta në jetë dhe e drejta në integritet fizik dhe psikologjik.

REFORMAT INSTITUTIONALE

Reforma institucionale është procesi i rishikimit dhe i ristrukturimit të institucioneve shtetërore në mënyrë që atotë respektojnë të drejtat e njeriut, të ruajnë shtetin e së drejtës dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj zgjedhësve të tyre.³⁹ Institucionet publike – siç janë policia, ushtria dhe gjyqësori – shpesh janë instrumente të shtypjes dhe të shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut në shoqëritë, të cilat përjetojnë konflikt ose autoritarizëm. Kur tranzicioni drejt paqes dhe qeverisjes demokratike ndodh, reforma e institucioneve të tilla është jetike dhe tradicionalisht konsiderohet thelbësore për drejtësinë tranzicionale.

Me kalimin e viteve, megjithatë, përvoja ka treguar se një fokus i ngushtë në institucionet e përfshira drejtpërdrejt në abuzimin fizik nuk është i mjaftueshëm. Shpesh nevojitet reformimi i të gjitha dikastereve të qeverisë dhe krijimi i mekanizmave të duhur mbikëqyrës për të siguruar pavarësinë e tyre profesionale. Kjo e kërkon rishikimin e një pjese të madhe të kuadrit ligjor në fuqi, duke filluar me kushtetutën. Pos kësaj, reformimi i institucioneve të drejtësisë dhe të sigurisë duhet të plotësohet me ndryshime në institucionet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore nëse një shoqëri mund të përballë plotësisht me të gjitha shkeljet, përfshirë ato ekonomike dhe sociale.⁴⁰

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

SKDT duhet të marrë parasysh sa vijon për të rritur profesionalizmin dhe besueshmërinë e institucioneve publike në respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut:

- 1** Të krijohet një kuadër ligjor për kontrollin dhe verifikimin e vazhdueshëm të punonjësve në institucionet publike dhe të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të sigurohet që publiku të veprojë në përputhje me parimet e profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies së plotë ndaj qytetarëve.
- 2** Krijimi i proceseve dhe kapaciteteve për të ngritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë e qytetarëve dhe të institucioneve për rëndësinë e procesit të drejtësisë tranzicionale dhe për ndikimin e tij të mundshëm në shoqëri dhe në brezat e ardhshëm.

³⁹<https://www.ictj.org/institutionalreform#:~:text=Institutional%20reform%20is%20the%20process,are%20accountable%20to%20their%20constituents.>

⁴⁰ ibid

3 Vendosija e udhëzimeve të sakta për të luftuar revizionizmin historik dhe mohimin e krimeve të luftës, duke përfshirë vendosjen e dënimeve thelbësore për shkeljet e kryera.

VI. KOMPLEMENTARITETI – ELEMENTET MBËSHTETËSE

Më poshtë janë "Elementet mbështetëse" për të plotësuar proceset e drejtësisë tranzicionale duke i lidhur proceset dhe mekanizmat plotësues.

- Qasja në drejtësi – ofrimi i qasjes në drejtësi është një qëllim i përbashkët i drejtësisë tranzicionale thelbësor për arritjen e objektivave afatgjata të zhvillimit dhe të ndërtimit të paqes. Në këtë drejtim, çështjet e përfshirjes gjinore dhe pengesat unike që hasin gratë në qasjen e tyre në drejtësi kërkojnë vëmendje të veçantë.
- Ndihma juridike dhe ndërgjegjësimi ligjor - Ndihma juridike për viktimat ka shumë forma, duke përfshirë këshillimin ligjor, çështjet gjyqësore strategjike, paraqitjen e ankesave ose përfaqësimin ligjor. Të drejtat themelore ndërgjegjësuese dhe mjetet juridike në dispozicion për viktimat janë të nevojshme për të rritur raportimin e shkeljeve dhe për të ofruar ndihmë juridike për personat në nevojë. Viktimat dhe familjet e tyre, të cilat i përkasin grupeve më të pafavorizuara, përballen me marginalizimin e vazhdueshëm për shkak të çështjeve të pazgjadhura sistematike, të tilla siç janë reparacionet, fuqizimi ekonomik dhe të drejtat themelore për strehim, arsim dhe punësim.
- Komunikimi dhe shërbimet publike – janë thelbësore për rritjen e ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit të qëllimeve dhe funksionimit të proceseve dhe mekanizmave të drejtësisë tranzicionale. Strategjitë e kujdesshme të komunikimit dhe të shërbimeve publike, duke përfshirë hartimin e mesazheve të synuara për të gjitha grupet përkatëse, do të rrisin mbështetjen e publikut për përpjekjet për drejtësinë tranzicionale dhe institucionet shtetërore.
- Fokusi në të rinjtë - Konflikti në Kosovë prek veçanërisht rininë. Edhe pse shumica dërrmuese nuk kanë qenë të lindur ende, historitë familjare dhe kujtimet konfliktuale kanë lënë gjurmë të përherëshme në ta dhe të rinjtë janë të ekspozuar ndaj urrejtjes ndaj grupeve të tjera etnike, nacionalizmit dhe segregacionit. Pos kësaj, të rinjtë në Kosovë kanë mundësi të kufizuara për të takuar bashkëmohatarë nga pjesët e tjera të rajonit ose grupet etnike, gjë që rezulton në rritjen e pikëpamjeve ksenofobike dhe etnocentrike. Narrativat përçarëse dhe historitë kontradiktore të konfliktit të dhunshëm/luftës së dhunshme, traumave ndërmjet brezave, propagandës dhe manipulimit politik, mungesës së mediave të pavarura të lajmeve, të gjitha këto së bashku ndikojnë në gjeneratat e ardhshme në Kosovë. SKDT duhet t'i japë prioritet aktiviteteve rinore dhe shkëmbimeve me bashkëmohatarët në rajonin e Ballkanit Perëndimor për të ndryshuar këtë prirje.

- **Arsimimi - Ndarja sociale dhe perceptimet etnocentrike të historisë janë rënduar thellësisht nga segregacioni në sistemet arsimore në Kosovë, në të cilat komunitetët shqiptar i mësohet një kurrikulë e veçantë e menaxhuar nga shteti i Kosovës. Përkundër kësaj, komunitetët serb i mësohet planprogrami serb në shkollat e menaxhuara nga shteti serb. Kjo do të thotë se fëmijët nga të dy komunitetët kanë mundësi të kufizuara për të pasur kontakte me njëri-tjetrin dhe iu mësohen pikëpamje krejtësisht të ndryshme dhe të kundërta të historisë. Për më tepër, asnjë komunitet brenda sistemit të tyre shkollor nuk ka mundësi të mësojë gjuhën e tjetrit, duke lënë një brez krejt të ri pa një gjuhë të përbashkët, përveç anglishtes, frëngjishtes ose gjermanishtes. Drejtësia Tranzicionale duhet të futet në kurrikulat e arsimit për shkollat fillore dhe të mesme. Kjo mund të ndihmojë në nxitjen e një kulture të dialogut, të vlerave demokratike dhe respektit për të tjerët.**
- **Luftimi i stigmatizimit - Shoqëria kosovare nuk është mjaft e sensibilizuar në lidhje me personat e traumatizuar, veçanërisht lidhur me viktimat e dhunës seksuale që ka të bëjë me konfliktin, i cili çon në përjashtimin social. Nga frika e stigmatizimit dhe e përjashtimit social dhe familjar, personat e traumatizuar dhe familjet e tyre shpesh refuzojnë të përballen me problemin e traumatizimit dhe e fshehin atë nga shoqëria me qëllimin që ta ruajnë statusin e tyre social. Këto rrethana janë një nga faktorët kritik kufizues, që parandalojnë kujdesin e suksesshëm psikosocial për personat e traumatizuar, ri-integrimin e tyre social dhe përhapjen e njohurive për traumën. Stigmatizimi është ekstrem në radhët e viktimave të abuzimit seksual dhe përdhunimit (si gra ashtu edhe burra), dhe kjo ndodh kryesisht për arsye kulturore dhe marrëdhënie familjare.**
- **Monitorimi - SKDT duhet të përfshijë formimin e një "Trupi Monitorues Zbatues" si një organ i përhershëm dhe i pavarur, i cili monitoron zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë dhe e këshillon publikun. Përveç kësaj, duke qenë se procesi i hartimit të kësaj Strategjie tashmë përfshin disa OSHC dhe aktivistë civilë, një konsorcium i OSHC-ve dhe i aktivistëve duhet të mandatohet nga SKDT për të ofruar raporte këshillimore periodike dhe të veçanta me qëllim të informimit lidhur me hartimin dhe me zbatimin e Strategjisë përfundimtare.**

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

Drejtësia tranzicionale – me mekanizmat e saj të ndërlidhur të së vërtetës, drejtësisë, dëmshpërblimit dhe garancive të mospërsëritjes – jep një kontribut thelbësor në rrugëtimin e tranzicioneve komplekse të shënuara nga interesa konkurruese, pakënaqësi shoqërore dhe individuale, dhe ku narrativat përçarëse edhe më tutje rrezikojnë polarizimin e mëtejshëm të shoqërisë dhe politikës.

Proceset e drejtësisë tranzicionale duhet të jenë në pronësi kombëtare dhe të përqendrohen në nevojat e viktimave, që mund të lidhen, të fuqizohen dhe transformohen përmes dialogut dhe ballafaqimit me të kaluarën. Nismat e kërkimit të së vërtetës mund të ofrojnë një platformë për identifikimin e të përbashkëtave në përvojë, për pranimin e narrativave të shumëfishtë dhe për krijimin e platformave për korrigjim dhe pajtim. Proceset gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale, të cilat janë pjesëmarrëse dhe kërkojnë pronësi të gjerë shoqërore, mund të jenë thellësisht fuqizuese për viktimat, veçanërisht për grupet e marginalizuara – duke iu dhënë atyre zë dhe mundësi veprimi për të formuar të ardhmen e tyre si pronar të të drejtave. Së fundi, përmes .

dëmshpërblimeve dhe garancive për mospërsëritje, reparacioneve dhe mospërsëritjes, drejtësia tranzicionale mund t'i transformojë shoqëritë dhe t'i vendosë ato në një shteg të ri për të ardhmen.⁴¹

Elementet dhe aktivitetet e mëposhtme do të informojnë procesin dhe duhet të shërbejnë si parime udhëzuese për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë Tranzicionale për Kosovën:

1 Rishikimi dhe përfshirja në një planifikim "të plotë" të iniciativave të Drejtësisë Tranzicionale, mësimave të nxjerra nga ato nisma dhe komenteve dhe rekomandimeve përkatëse.

2 Inkorporimi i kërkimeve bashkëkohore, miratimi i praktikave më të mira, analiza dhe listimi i normave dhe i standardeve ndërkombëtarisht të njohura.

3 Identifikimi i kapaciteteve drejtuese për hartimin, për promovimin dhe për zbatimin efektiv të SKDT.

4 Propozimi për formimin e një Komisioni të së Vërtetës ose një organi të ngjashëm për kërkimin e së vërtetës si pjesë përbërëse e SKDT.

5 Inkorporimi i mësimave të nxjerra - nga "Grupi Punues Ndërministror i mëparshëm për Ballafaqimin me të kaluarën dhe pajtimin", duke i përfshirë rekomandimet në lidhje me mangësitë procedurale dhe thelbësore në planifikim dhe dizajn, udhëheqje dhe menaxhim: Përbërja e grupit punues, mungesa e financave të dedikuara dhe urimet njerëzore: Parregullsi në takime, mungesa objektive e shërbimeve publike dhe e komunikimit dhe mungesa e mbikëqyrjes parlamentare.⁴²

6 Inkorporimi i rritjes së ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i konsensusit për të forcuar pranimin e SKDT nga palët e interesuara, individët e prekur dhe komunitetet, duke përfshirë programet arsimore mbi Drejtësinë Tranzicionale në shkolla, media dhe grupe të shoqërisë civile.

7 Përfshirja e Drejtësisë Tranzicionale në dialogun Prishtinë-Beograd të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe diskutimet me BE-në rreth Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) për të mbështetur një qasje të përqendruar te viktimat për konsolidimin e paqes dhe një normalizim të negociuar të marrëdhënieve.

IX. ANEKSET

ANEKSI I

PARIMET PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT PËRMES VEPRIMIT PËR TË LUFTUAR PANDËSHKUESHMËRINË⁴³

LUFTIMI I PANDËSHKIMIT: DETYRIMET E PËRGJITHSHME

⁴³<http://derechos.org/nizkor/impu/principles.html>

II. E DREJTA PËR TË DITUR

A. Parimet e përgjithshme

- Parimi 1. Detyrimet e përgjithshme të shteteve për të ndërmarrë veprime efektive për të luftuar mosndëshkimin
- Parimi 2. E drejta e patjetërsueshme për të vërtetën
- Parimi 3. Detyra për të ruajtur kujtesën
- Parimi 4. E drejta e viktimave për të ditur
- Parimi 5. Garancia për t'i dhënë efekt të drejtës për të ditur

B. Komisionet Hetimore

- Parimi 6. Themelimi dhe roli i komisioneve të së vërtetës
- Parimi 7. Garancitë e pavarësisë, paanshmërisë dhe kompetencës
- Parimi 8. Përkufizimi i termave të referencës së komisionit
- Parimi 9. Garancitë për personat e implikuar
- Parimi 10. Garancitë për viktimat dhe dëshmitarët që dëshmojnë në emër të tyre
- Parimi 11. Burimet adekuate për komisione
- Parimi 12. Funkcionet këshillimore të komisioneve
- Parimi 13. Publikimi i raporteve të Komisionit

C. Ruajtja dhe qasja në arkivat që dëshmojnë për shkelje

- Parimi 14. Masat për ruajtjen e arkivave
- Parimi 15. Masat për lehtësimin e qasjes në arkiva
- Parimi 16. Bashkëpunimi ndërmjet arkivave, gjykatave dhe komisioneve hetimore jo-gjyqësore
- Parimi 17. Masat specifike në lidhje me arkivat që përmbajnë emra
- Parimi 18. Masat specifike që lidhen me rivendosjen ose kalimin drejt demokracisë dhe paqes

III. E DREJTA NË DREJTËSI

A. Parime të përgjithshme

- Parimi 19. Detyrat e shteteve në lidhje me administrimin e drejtësisë

B. Shpërndarja e juridiksionit ndërmjet gjykatave kombëtare, të huaja, ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara

- Parimi 20. Juridiksioni i gjykatave penale ndërkombëtare dhe të ndërkombëtarizuara
- Parimi 21. Masat për forcimin e efektivitetit të parimeve juridike ndërkombëtare në lidhje me juridiksionin universal dhe ndërkombëtar

C. Kufizimet në rregullat e ligjit të justifikuara me veprimet për të luftuar mosndëshkimin

- Parimi 22. Natyra e masave kufizuese
- Parimi 23. Kufizimet e parashkrimit
- Parimi 24. Kufizimet dhe masat e tjera që kanë të bëjnë me amnistinë
- Parimi 25. Kufizimet e së drejtës për azil
- Parimi 26. Kufizimet e ekstradimit/non-bis in idem
- Parimi 27. Kufizimet në arsyetimet që lidhen me bindjen e duhur, përgjegjësinë eprore dhe statusin zyrtar
- Parimi 28. Kufizimet në efektet e legjislacionit mbi zbulimin ose pendimin
- Parimi 29. Kufizimet e juridiksionit të gjykatave ushtarake
- Parimi 30. Kufizimet në parimin e pazgjidhshmërisë së gjyqtarëve

IV. E DREJTA PËR NDËRMARRJE/GARANCI PËR MOS-PËRSËRITJE

A. E drejta për dëmshpërblim

- Parimi 31. Të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga detyrimi për të bërë dëmshpërblim
- Parimi 32. Procedurat e dëmshpërblimit
- Parimi 33. Publikimi i procedurave të dëmshpërblimit
- Parimi 34. Fushëveprimi i së drejtës në dëmshpërblim

B. Garancitë për mospërsëritje të shkeljeve

- Parimi 35. Parime të përgjithshme
- Parimi 36. Reforma e institucioneve shtetërore
- Parimi 37. Shpërbërja e forcave të armatosura parashtetërore/demobilizimi dhe ri-integrimi social i fëmijëve
- Parimi 38. Reforma e ligjeve dhe e institucioneve, të cilat kontribuojnë në mosndëshkimin

ANEKSI II

FJALOR

MEKANIZMAT JO-GJYQËSORE TË DREJTËSISË KALIMTARE

Strategjia e Drejtësisë Tranzicionale përfshin mekanizmat e mëposhtëm jo-gjyqësor: gjetjen e fakteve dhe tregimin e së vërtetës, dëmshpërblimet, memorialët dhe reformat institucionale. Këta mekanizma quhen “jo-gjyqësorë”, sepse aktivitetet e tyre përkatëse zbatohen jashtë sistemit gjyqësor me anë të rregullimeve të ndryshme ligjore, politike dhe institucionale. Veprimtaritë jo-gjyqësore nuk kanë të njëjtat mandate dhe as të njëjtin ndikim si mekanizmat gjyqësorë. Megjithatë, aktivitetet jo-gjyqësore kanë, në një kuptim më të gjerë, një ndikim moral mbi individët dhe mbi shoqërinë, në tërësi, ndërsa rezultati i veprimtarive gjyqësore janë vendimet përfundimtare dhe detyruese, d.m.th., vendosja e sanksioneve në çështjet civile dhe penale.

NISMAT JOZYRTARE DHE ZYRTARE PËR DREJTËSINË TRANZICIONALE

“Nisma jozyrtare” nënkupton aktivitetet e iniciuara dhe të zbatuara nga shoqëria civile (në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar). Ndryshe nga kjo, “nismat zyrtare” nënkuptojnë aktivitetet e iniciuara

dhe të zbatuara nga qeveria dhe institucionet e tjera publike (në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar). Megjithatë, Strategjia e Drejtësisë Tranzicionale nuk përdor termat "nisma jozyrtare dhe zyrtare"; në vend të kësaj, përdor "nismat e zbatuara nga shoqëria civile" ose "nismat e shoqërisë civile" për t'iu referuar të ashtuquajturave "nisma jozyrtare" dhe "nismat e zbatuara nga qeveria dhe institucionet e tjera publike" për t'iu referuar të ashtuquajturave "nisma zyrtare", duke u fokusuar vetëm në iniciativat kombëtare.

MEKANIZMAT INSTITUCIONAL JOGJYQËSORE TË GJETJES SË FAKTEVE DHE TË TREGIMIT TË SË VËRTETËS

Mekanizmat institucional jo-gjyqësorë për gjetjen e fakteve dhe të tregimit të së vërtetës janë organe hetimore të pavarura dhe të formuara ad hoc për të hetuar çështjet e përcaktuara në mandatet e tyre dhe për të informuar publikun për gjetjet e tyre. Atyre iu referohemi si; "jo-gjyqësore" sepse, ndryshe nga gjykatat, ato nuk marrin vendime detyruese dhe as vendosin sanksione penale dhe civile. Në rast të deklarimeve të rreme, pengimit të efikasitetit të mekanizmit institucional jo-gjyqësor, të shkatërrimit të dokumenteve etj., mekanizmi institucional jo-gjyqësor nuk mund t'i dënojë këto akte. Ndryshe nga mekanizmi gjyqësor, në mekanizmin institucional jo-gjyqësor nuk ka palë. Mekanizmi gjyqësor është i fokusuar tek shkelësit individual të të drejtave të njeriut në proceset penale dhe civile, ndërsa mekanizmi institucional jo-gjyqësor është i fokusuar tek viktimat. Megjithatë, linja ndërmjet mekanizmave gjyqësorë dhe jo-gjyqësorë nuk është aq e rreptë. Një nga shembujt është kompensimi si një formë e dëmshpërblimit. Në përgjithësi, dëmshpërblimet janë një mekanizëm jo-gjyqësor. Megjithatë, kompensimi mund të sigurohet përmes procedurave administrative dhe gjyqësorit duke paraqitur pretendime për dëmtime fizike dhe për ankth mendor. Gjithashtu, ndjekja penale dhe ndëshkimi i atyre që mbajnë përgjegjësi për krimet e luftës – si një mekanizëm gjyqësor – mund të sjellë kënaqësi për viktimat si një formë dëmshpërblimi, që është, sui generis, një formë jo-gjyqësore.

TREGIMI I SË VËRTETËS /KËRKIMI I SË VËRTETËS/GJETJA E FAKTEVE

Strategjia e Drejtësisë Tranzicionale përdor termat "tregim i së vërtetës", "kërkim i së vërtetës" dhe "gjetje e fakteve". Një nga mekanizmat e drejtësisë tranzicionale, që mbulohet nga kjo Strategji, është gjetja e fakteve dhe tregimi i së vërtetës. Në teorinë dhe në praktikën tranzicionale të drejtësisë tranzicionale, termat "tregim i së vërtetës" dhe "gjetje e fakteve" zakonisht përdoren në mënyrë të ndërsjellë, megjithëse ka dallime të ndjeshme midis tyre. Në mënyrë të veçantë, "gjetja e fakteve" nënkupton një nevojë të përhershme për informacion, d.m.th., njohuri dhe hetim, dhe fakte për të kaluarën që duhet të shqyrtohen. Termi "tregim i së vërtetës" i referohet proceseve përmes të cilave shtetet dhe shoqëritë tregojnë histori për periudhat e kaluara traumatike, siç janë konfliktet e armatosura, dhe termi e nënkupton nevojën që zëra të ndryshëm të dëgjohen dhe të ndajnë përvojat e kaluara, gjë që iu jep atyre që më së shumti janë të ndikuar (viktimave) një ndjenjë fuqizimi dhe njohjeje. Termi "gjetje e fakteve" e tregon nevojën për të ashtuquajturën "e vërteta mjeko-ligjore", e vërteta e bazuar në prova, d.m.th., në vërtetimin e një të vërtete të tillë.

VETINGU

Për Strategjinë e Drejtësisë Tranzicionale vetingu është përcaktuar: si një veprimtari jo-gjyqësorë që përfaqëson një procedurë për kontrollin e historikut të nëpunësve publik nëpërmjet shqyrtimit të

kapaciteteve të tyre profesionale dhe integritetit moral me qëllim të përcaktimit të përshtatshmërinë së tyre për poste publike. Kapaciteti profesional përfshin kontrollimin e kualifikimeve të kërkuara për një punë, përvojën profesionale dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional përmes trajnimeve të specializuara. Integriteti moral e nënkupton respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, sjellje (jo) korruptive, paanshmëri dhe (mos)diskriminim. Rezultati i vetingut nuk është dënim penal. Megjithatë, verifikimi në shumicën e rasteve rezulton në ulje, referim për arsim shtesë dhe largim nga detyra, përkohësisht ose përgjithmonë, duke iu lejuar zakonisht nëpunësve publik të aplikojnë përsëri për të njëjtën detyrë në të ardhmen. Në rastet më ekstreme, vetingu rezulton me largim nga detyra pa të drejtë ankimi. Procesi i verifikimit nënkupton se ekziston një organ unik dhe i jashtëzakonshëm e i pavarur, i cili do të përcaktojë përshtatshmërinë e një nëpunësi publik/nëpunësi civil për poste publike dhe standardet bazë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të zyrtarit publik/nëpunësit civil, të cilat janë në përputhje me parimet demokratike dhe me sundimin e ligjit (e drejta për të punuar në shërbimin publik; e drejta për t'u mbrojtur nga sulmet e paligjshme ndaj nderit dhe reputacionit; e drejta për një mjet juridik efektiv; e drejta për prezumimin e pafajësisë; e drejta për një gjykim të drejtë para një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme; e drejta për barazi para gjykatës dhe mbrojtje e barabartë e ligjit; e drejta për punë.)

RIEMËRIMI (Veting)

Riemërimi është një formë e veçantë e vetingut, që nënkupton reforma thelbësore brenda një institucioni në strukturë dhe në burime njerëzore. Në terma strukturorë, një riemërim nënkupton heqjen, rindërtimin, riorganizimin e një institucioni apo edhe formimin e një institucioni të ri. Për sa i përket burimeve njerëzore, të gjitha pozitat e institucioneve shpallen të lira dhe shpallen publikisht konkurset për përzgjedhjen dhe për rekrutimin e personave më të përshtatshëm për punë. Të gjithë personat që plotësojnë kriteret e punës mund të aplikojnë, duke përfshirë këtu edhe ata që tashmë punojnë në ato institucione, nëse ata duan të vazhdojnë të punojnë. Procedura e riemërimit nënkupton që aplikantët duhet të dëshmojnë përshtatshmërinë e tyre për punët, për të cilat kanë aplikuar, siç është rasti me aplikimet e rregullta për punë të tjera. Në rast riemërimi, barra e provës bie mbi aplikantët.

LUSTRACIONI

Lustracioni është një formë specifike e vetingut. Ai nuk shqyrton performancën individuale, duke e kontrolluar kapacitetin profesional dhe integritetin moral; në vend të kësaj, ai konstaton lidhjen (përkatësinë), ose mungesën e lidhjes, ndërmjet një individi dhe një organizate politike, një njësie ose institucioni ushtarak ose policor, ose një grupi në përgjithësi, që besohet se është përgjegjës për abuzimin e të drejtave të njeriut. Bazuar në konstatimin nëse ekziston apo jo një lidhje e tillë, bëhet deklarimi nëse dikush është apo jo i përshtatshëm për poste publike. Ashtu si edhe vetingu, edhe lustracioni nuk nënkupton asnjë dënim penal. Pasojat e vendosjes së përshtatshmërisë për administratën publike janë të ngjashme me ato të procesit të vetingut; megjithatë, ato bazohen kryesisht në largimin nga postet publike.

VIKTIMA

Termi "viktimë" rrjedh nga paragrafi 8 i Rezolutës 60/147 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së: Parimet

dhe Udhëzimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën për zgjidhje dhe dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. Viktimat janë persona që kanë pësuar lëndime individuale ose kolektive, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose dëmtim të konsiderueshëm të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, që përbëjnë shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut ose shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Kur është e përshtatshme, termat Viktima dhe të mbijetuar janë të zëvendësueshëm njëri me tjetrin.

VIKTIMA CIVILE E LUFTËS

Në kohë të luftës ose rreziku të drejtpërdrejtë të luftës, është ai person që ka pësuar lëndime/plagosje, të cilat kanë shkaktuar lëndime trupore ose mendore ose dëmtime të rënda të shëndetit ose vdekje dhe i cili nuk konsiderohej si luftëtar ose i tillë që ka marrë pjesë në aktivitete ushtarake.

VIKTIMË E TORTURËS

Personi i cili ka pësuar lëndime trupore për shkak të torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, dhunës seksuale, përdhunimit, dënimit të paligjshëm, privimit të paligjshëm nga liria në vendet e ngujimit dhe punës së detyruar gjatë luftës ose rrezikut të drejtpërdrejtë të luftës.

PERSON I ZHDUKUR

Personi i zhdukur është personi për të cilin familja e tij/saj nuk ka informacion dhe i cili raportohet i zhdukur në bazë të informacioneve të besueshme për shkak të konfliktit të armatosur.

VENDET E NGUJIMIT

Dokumentet ndërkombëtare, të tilla si Konventa e Gjenevës III (për të burgosurit e luftës) dhe Konventa e Gjenevës (IV) (mbrojtja e civilëve në një konflikt të armatosur), nuk përmbajnë përkufizime të nocioneve të tilla si kampi i përqendrimit, vendet e ngujimit, qendrat e grumbullimit. Megjithatë, ky nocion mbulon aktet e paligjshme individuale dhe në shkallë të gjerë të izolimit ose të ngujimit të paligjshëm të personave në mbarë Kosovën gjatë konfliktit, në të cilat janë kryer aktivitete kriminale, si trajtimi çnjerëzor, tortura dhe trajtime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

ÇRREGULLIMI I STRESIT POST-TRAUMATIK (PTSD)

Çrregullimi i stresit post-traumatik është një dëm psikologjik i shkaktuar nga një përvojë traumatike, një ngjarje përtej çdo përvoje njerëzore dhe që shkakton një ndjenjë shoku. PTSD shfaqet si një përgjigje e vonuar ose e përzgatur ndaj një ngjarjeje stresuese dhe mund të shfaqë shenjat e para shumë vite më vonë.

KRIMI I LUFTËS

Një krim lufte - është një term i përgjithshëm, i cili mbulon një varg veprash penale të dënueshme sipas ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin.

KRYERËSI I KRIMIT

Termi "kryerës i krimit" përfshin këto kategori: kryerësit e drejtpërdrejtë të krimeve, bashkëpunëtorë (nxitësit, ndihmësit dhe të tjerët). E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet vetëm gjatë një konflikti të armatosur, pavarësisht nga karakteri i konfliktit (konflikt ndërkombëtar ose i brendshëm).

VENDET E NDËRGJEGJËSIMIT

Vendet e ndërgjegjes janë hapësira publike dhe monumente për të mbrojtur kujtesën dhe interpretimin e historisë, përmes inkurajimit për përfshirjen aktive të qytetarëve në një dialog të hapur e të gjerë mbi trashëgimitë e së kaluarës.

Prishtinë, Qershor 2022

Copyright © 2022 Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë